

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7481 E mërkurë 28 Mars 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**
Pas vërshimit të njëpasnjëshëm të taksave shtetërore dhe lokale, ja edhe një taksë tjetër, e cila vjen si një rrufe në mot të kthjellët, taksa e Rrugës së Kombit...
Vijon në faqen 21

Nga SULEJMAN MATO
Rruga e Kombit, taksa e patriotizmit për kosovarët



Opinion **Ditës**
Sa herë që flitet për negociatat me SBE-në përmenden me të drejtë standardet, lufta kundër korrupsionit, krimit të organizuar, reformimi i gjyqësorit, vetingu, etj...
Vijon në faqen 20

Nga DR. JORGJI KOTE
Evropa në të përditshmen tonë



LISTA E DYTE/ Kujt i njihet prona

Dosjet e pronarëve në vitin 1997, emrat e vlera e kompensimit për 1462 përfitues

Agjencia e Trajtimit të Pronave: Afati i fundit për plotësimin e dokumenteve...

Nga ORNELA MANJANI
Agjencia e Trajtimit të Pronave ka përfunduar procesin e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare për dosjet e vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar në të gjithë vendin. Në përfundim të procesit...

Në faqen 10-11

BASHKIA E TIRANES: DO TE PERFITOJNE 500 FAMILJE, JA HAPAT QE DUHET TE NDIQNI

HAPEN PROCEDURAT PER KREDINE E BUTE, NDRYSHOJNE 3 KRITERE

Financimi për shtëpinë, rritet mosha e çiftit aplikant dhe afati i subvencionimit të kredisë nga 15 në 20 vjet. Ndryshojnë kriteret edhe për të ardhurat



(Në foto) Faksimile e "Formularit të Strehimit TIP" për aplikimin e llogaritjes së kredisë së butë

INTERVISTA

Rama: Jemi anëtarë të NATO-s, paradoks që nuk jemi në BE, rrezik nga palët e treta

Në faqen 2

DEBIMI I DIPLOMATEVE

Çfarë raporto i kreu i SHISH 3 orë në Komisionin e Sigurisë, nga rusët te droga

Në faqen 3

MARRËDHENIET ME GREQINE

"Çështja e paqenë e detit", diplomati Shaban Murati promovon librin e ri

Në faqen 21

ÇFARË NDOHDI

Gjyqi i Shullazit, trupi gjyqësor nuk pranon kërkesën për të thirrur dëshmitar Ardian Çipën

Në faqen 9

FLET INA ZHUPA



Rrëfimet zëdhënësja e PD-së: Si punohet me Bashën. Do e ktheja në demokrat edhe të fejuarin

Suplement

Qytetarët mbështesin aktorët, protestojnë kundra shembjes së godinës

Ema Andrea: Kullat do "i marrin frymën" teatrit

Aktorja: Politika të mos na vijë në funeral. Secili të mbajë kryqin e vet mbi shpinë

Nga FATMIRA NIKOLLI
Teatri Kombëtar për mua: një dashuri e dhimbshme për të cilën do vazhdoj të jetoj e të punoj sa të mundem, pa kërkuar lapidarë sakrificash apo viktimash. Uroj të jem gjallë e të dëgjoj një 'më fal' nga politika për artistët.



Nëse nuk do e dëgjoj, uroj të mos kenë kurajë të vijnë në funeralin tim, apo të asnjë artisti! Për momentin dëgjojmë 'plasje'. Për sa të mundem, për këtë do punoj e luftoj, qoftë edhe e vetme dhe e paragjykuar". Kjo është deklarata e aktreses dhe...

Në faqen 18-19

NDIKIMI RUS INTERVISTA

Ndikimi rus, turk apo kinez? Kryeministri: Nuk frikësohem nga asnjëri

Rama: Jemi anëtarë të NATO-s, paradoks që nuk jemi në BE, rrezik nga palët e treta

"Çështja e kanabisit, flluskë. Ne pastruam vendin"

E është paradoksale që nuk jemi në BE", deklaroi dje në një intervistë për të përditshmen gjermane "Die Welt", kryeministri Edi Rama, ndërsa theksoi se sa e rëndësishme është për Europën, jo vetëm Shqipëria, por tërë Ballkanin Perëndimor. "Ne jemi e kundërta e asaj çka thonë për ne kundërshtarët e zgjerimit, ne jemi një faktor për qëndrueshmëri dhe siguri në Europë. Nuk do të ishte mirë për BE-në të linte Ballkanin si një zonë gri në të cilën palët e treta të mund të përfshihen. Nuk duhet harruar se ne jemi anëtarë të NATO-s", shprehet Rama.

Zoti kryeministër: Plani i zgjerimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor ka lejuar fqinjët tuaj, Serbinë dhe Malin e Zi që të nisnin ndërkohë bisedimet e anëtarësimit. Shqipëria është ende në dhomën e pritjes. A ju bezdis një fakt i tillë?

Jo, sepse kemi pasur diferencë në pikënisje. Serbia ishte një vend kandidat përpara nesh, ndaj ishte normale që Serbia të merrte dritën jeshile të hapjes së negociatave më përpara. Ne fituam statusin e vendit kandidat pasi përmbushëm me sukses një listë të gjatë kushtesh. Megjithatë, besoj se sinqerisht, negociatat duhet të kishin nisur deri më tani, pasi kemi përmbushur ta gjithë detyrimet tona. Pika më e rëndësishme ishte reforma në sistemin e drejtësisë, zbatimi i së cilës ishte i vështirë. Na u desh të ndryshonim Kushtetutën e kjo nuk është një gjë e zakonshme. Ne kemi ndryshuar të gjithë arkitekturën e sistemit tonë të drejtësisë. Aktualisht kemi nisur një sistem verifikimi për të gjithë anëtarët e sistemit të drejtësisë. Askush nuk e ka bërë këtë më parë. Ndaj nuk është qesharake që ne kërkim hapjen e negociatave, teksa Serbia dhe Mali i Zi tashmë e kanë nisur këtë rrugë.



Strategjia e zgjerimit të BE-së u ka dorëzuar atyre një plan veprimi, që pak a shumë i kërkon të njëjtën gjë që ne kemi zbatuar tashmë, një reformë në drejtësi, përfshi mekanizmat e vettingut. Të dyja këto shtete duhet të realizojnë një proces që ne e kemi realizuar tashmë. E megjithatë, ato janë duke negociuar, ndërsa ne ende jo. Ky është një prej shembujve të shumtë që tregojnë se procesi i anëtarësimit nuk është edhe aq teknik apo meritokratik sa do të duhej të ishte.

Ekzistojnë dy metra të ndryshëm nga BE për të matur arritjet tuaja?

Nuk do ta thosha këtë. Nuk besoj se vende të ndryshme trajtohen qëllimisht më mirë se vende të tjera. Por, progresi i një shteti varet shumë edhe nga reputacionin e atij vendi brenda BE-së. Nuk mjafton vetëm të bësh detyrat e shtëpisë.

A vuan Shqipëria nga një imazh negativ?

Mënyra se si percepton diçka është një vendim. Mund ta shohësh në disa mënyra. Për vende si tonat do të ketë gjithmonë arsye

për të thënë, "po, por?". Ne as po kërkim të anëtarësohemi tani. Duam vetëm nisjen e negociatave.

Pra, fakti që negociatat nuk kanë nisur ende, lidhet ekskluzivisht me perceptimin negativ të vendit tuaj?

Do t'iu tregoj një histori të disa muajve më parë, pa përmendur emra të

DEKLARATA

"Nuk do të ishte mirë për BE-në të linte Ballkanin si një zonë gri në të cilën palët e treta të mund të përfshihen. Nuk duhet harruar se ne jemi anëtarë të NATO-s, është paradoksale që nuk jemi në BE. Nuk është pak ajo që u tregua në Mal të Zi, mbi ku mund të çojë ndikimi rus. Një qeveri kundër NATO-s dhe BE-së është ende një mundësi shumë realiste", tha Rama.

përveçëm njerëzish apo shtetesh. Një i ftuar VIP, nga një vend anëtar erdhni tek ne disa muaj më parë. Një vend që ka disa rezerva ndaj nesh. Ky person mbërriti i shoqëruar me policë, prokurorë dhe një tufë me gazetarë në seksionin VIP të aeroportit e nuk pranonin të largoheshin nga aeroporti pa një makinë të blinduar. Njerëzit tanë i thanë: "Na vjen keq, por nuk e ofrojmë këtë shërbim. Si gjithmonë, kemi sjellë për ju një patrullë të armatosur,

por jo automjete të blinduara". Në fund të ditës, nuk jemi as në Bagdad dhe as në Kabul. E megjithatë, ju desh 45 minuta që të bindej. Të nesërmen më tha: "Të detyrohem një ndjesë, pasi vendi juaj është krejt ndryshe nga sa e kisha imagjinuar. Tirana është një qytet i këndshëm mesdhetar, diplomatët tuaj janë njerëz profesionistë, etj., etj.". Megjithatë, në vendin e tij flitet shumë për "krimet e shqiptarëve etnikë". Iu përgjigja: "Nëse mendon me të vërtetë kështu, të lutem të thuash në shtëpinë tënde se si është Shqipëria reale. Nëse ju kemi 'kriminalitet etnik shqiptar' në vendin tuaj, nuk e di se si qeveria ime mund t'ju ndihmojë. Policia jonë është përgjegjëse vetëm për territorin shqiptar". E këtu në Shqipëri kemi një prej mesatareve më të ulëta të vrasjeve në të gjithë Europën. Ne jemi një vend i vogël, kemi problemet tonat, por nuk kemi asgjë të jashtëzakonshme. Mjafton të pyesni turistët që vijnë këtu çdo vit. Asnjëri nuk i preket as edhe një qime floku. Shqipëria është një vend i sigurt.

Kur prisni që të nisni

Megjithatë, ka çështje

sensacionale: ish-ministri juaj i brendshëm, Tahiri, po hetohet për të parë nëse ka lidhje me trafikun e drogës, pas hetimeve të nisura në Itali. Ai gjithashtu i shiti makinën një të afërmi dhe ky i fundit e përdori për të trafikuar drogë.

Së pari, unë nuk besoj se dëshimet ndaj një personi të vetëm mund të pengojnë përpjekjet e një shteti të tërë. Së dyti, është në dorë të drejtësisë të zbulojë të vërtetën përmes hetimeve. Unë nuk mendoj se ky rast do të zgjidhjet ndryshe në vende të tjera, nëse një emër shfaqet në një protokolli monitorimi. Ai u përjashtua nga grupi parlamentar dhe iu dorëzua drejtësisë. Çfarë



Ambasada ruse në Tiranë

heshin nga vetingu. Ky është një spastrim drastik i sistemit tonë të drejtësisë.

Shqipëria ka reputacionin e një vendi prodhues të drogës. Një raport i EUROPOL-it identifikon Shqipërinë si një prej prodhuesve kryesorë dhe një prej pikave kryesore të transitit të kanabisit për në Europë. Shqipëria është gjithashtu një vend transit për kokainën dhe heroinën.

Është krijuar një flluskë e madhe rreth çështjes së kanabisit. Por, ne kemi pastruar vendin dhe kemi shkatërruar mbi 2 mijë plantacione. Kanabisi ka qenë në këtë vend për më shumë se 25 vjet. E kemi luftuar masivisht. Kuptohet, nuk është një lojë fëmijësh, ndaj ka edhe të papritura, por sic tregon kontrolli ajror i realizuar nga partnerët tanë italianë, vendi është pastruar nga droga.

Megjithatë, ka çështje sensacionale: ish-ministri juaj i brendshëm, Tahiri, po hetohet për të parë nëse ka lidhje me trafikun e drogës, pas hetimeve të nisura në Itali. Ai gjithashtu i shiti makinën një të afërmi dhe ky i fundit e përdori për të trafikuar drogë.

Së pari, unë nuk besoj se dëshimet ndaj një personi të vetëm mund të pengojnë përpjekjet e një shteti të tërë. Së dyti, është në dorë të drejtësisë të zbulojë të vërtetën përmes hetimeve. Unë nuk mendoj se ky rast do të zgjidhjet ndryshe në vende të tjera, nëse një emër shfaqet në një protokolli monitorimi. Ai u përjashtua nga grupi parlamentar dhe iu dorëzua drejtësisë. Çfarë

mund të bëhet tjetër? Po, është një ngjarje shqetësuese, por duhen prova. Reagimi ynë ishte i qartë si kristali dhe tani hetimi vazhdon.

Çfarë mund t'i japë Shqipëria BE-së?

Mendoj se kancelarja gjermane e di këtë përgjigje më mirë se kushdo tjetër. Ajo e kupton se sa e rëndësishme është për Europën jo vetëm Shqipëria, por tërë Ballkanin Perëndimor. Ne jemi e kundërta e asaj çka thonë për ne kundërshtarët e zgjerimit, ne jemi një faktor për qëndrueshmëri dhe siguri në Europë. Nuk do të ishte mirë për BE-në të linte Ballkanin si një zonë gri në të cilën palët e treta të mund të përfshihen. Nuk duhet harruar se ne jemi anëtarë të NATO-s, është paradoksale që nuk jemi në BE. Nuk është pak ajo që u tregua në Mal të Zi, mbi ku mund të çojë ndikimi rus. Një qeveri kundër NATO-s dhe BE-së është ende një mundësi shumë realiste.

Cili të frikëson më shumë ndikimi rus, turk apo kinez?

Gjithsecili mundohet në mënyrën e tij të ndikojë, por qëllimet dhe metodat janë të ndryshme. Nuk frikësohem nga asnjëri, por nuk mendoj se duhet marrë për mirëqenë besnikëria e rajonit. Sipas të gjitha sondazheve, Shqipëria ka popullin mysliman më proeuropian dhe më proamerikan. Kjo sigurisht nuk është ku qëndron problemi. Mbi të gjitha, mos i fyeri njerëzit, por respektojini. Ne bëjmë çfarë na është kërkuar, jo sepse na e caktoi Brukseli, Berlina apo Parisi, por sepse duhet ta bënim. Tani le të nisim bisedimet për të vazhduar rrugën.



124 drejtues policie të përfshirë në trafik droge, SHISH nuk e mohon raportin sekret

Ndikimi rus, Bendo: Tendanca për të prekur administratën

Mbledhja me dyer të mbyllura, 3 orë debat te Siguria

Valentina Madani

Shërbimi Informativ Shtetëror mohon të ketë influenca të qarta ruse, por sipas këtij institucioni ka tendenca të tilla edhe në Shqipëri. Helidon Bendo, Drejtori i komanduar i Shërbimit Informativ Shtetëror, raportoi dje për tri orë me radhë me dyer të mbyllura në Komisionin parlamentar të Sigurisë për punën e institucionit. Për shkak të informacioneve që duhet të mbeten sekret, raporti është mbajtur larg publikut. Ndërkohë mësohet se deputetët e kanë pyetur kreun aktual të Shërbimit Informativ për ndikimin rus dhe dyshimet për financime ruse. SHISH disponon informacione se shërbimet inteligjente ruse kanë tendenca për të influencuar në nivele të ulta të administratës në Shqipëri, por deri në cilin nivel dhe kë pjesë të administratës, nuk është bërë e qartë. TCH raporton se këtë informacion zv.drejtori i SHISH Helidon Bendo ia paraqiti deputetëve të Komisionit të Sigurisë Kombëtare gjatë raportimit mbi punën e shërbimit sekretë gjatë vitit 2017. Deklarimi i Bendo's të kuptosh se shërbimet sekrete ruse kanë tentuar të rekrutojnë pjesëtarë të administratës shtetërore. Raporti vjen në një kohë kur Ministria e Jashtme shqiptare lajmëroi ambasaden ruse në Tiranë se dy zrytarë të lartë të saj, atashu ushtarak dhe sekretari i pare i ambasadës duhet të largohen si persona "non grata". Vendimi për largimin e dy diplomatëve rusë u mor nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme. Siç u njoftua edhe më herët nga MEPJ, dy diplomatët rusë u shpallën "non grata" në Shqipëri, pas konflikteve të këtyre ditëve të fundit mes Rusisë, Britanisë së Madhe si dhe vendeve të tjera të Europës, pas helmimit të ish-spiunit rus Sergei Skripal në Britani. Por gjatë mbledhjes së djeshme në komisionin kuvendror mësohet se përgjatë tre orësh me dyer të mbyllura, Bendo u pyet për ekzistencën e një raporti sekret për 124 drejtues të lartë policie të inkriminuar në trafik droge. Sipas burimeve, Ben-



Helidon Bendo, drejtori i komanduar i Shërbimit Informativ Shtetëror

TENDENCA
Deputetët e kanë pyetur kreun aktual të Shërbimit Informativ për ndikimin rus dhe dyshimet për financime ruse. SHISH disponon informacione se shërbimet inteligjente ruse kanë tendenca për të influencuar në nivele të ulta të administratës në Shqipëri, por deri në cilin nivel dhe kë pjesë të administratës, nuk është bërë e qartë.

ATASHEU

"Atashu ushtarak është zyrtar. Ky është si një gjest që 'ne e përzumë atashen dhe nuk duam të kemi më marrëdhënie me Rusinë". Kështu mendoj unë. E mira do të ishte që të kishte një bashkëpunim mes institucioneve që gjithçka të bëhej më e pjekur dhe më e arsyeshme", tha z.Klosi.



Dëbimi, Klosi: Vendimi i drejtë, por atashu ushtarak është zyrtar

Dëbimi i dy diplomatëve rusë nga Shqipëria komento het si i drejtë nga ish-kreu i SHISH Fatos Klosi. Ai tha se Shqipëria u solidarizua me aleancën e NATO-s dhe Britanisë e Madhe edhe pse sipas tij duhej një ndërveprim mes institucioneve në vend për të arritur këtë vendimarrje. "Nuk është problemi i numrit, por i mesazhit. Me këtë që bëjmë japin mesazhin se Shqipëria është anëtare e devotshme e NATO. Caktimi i tyre mund të mos jetë rastësi, por atashu ushtarak dihet që është përfaqësues i ushtrisë përkatëse në këtë vend dhe asi për detyrë të përmirësimit marrëdhëniet midis palëve. Është normale meqë po e bëjmë në kuadrin e NATO", -tha z.Klosi për Report TV. Po ashtu ai vuri në dukje se nuk është e rëndësishme se si janë etiketuar diplomatët rus, si spiunë apo agjentë, por është ajo çfarë ata raportojnë për vendin tonë. "Edhe ambasadori edhe sekretari i parë bëjnë raportin se çfarë ndodh në Shqipëri. Ata paguhen për këtë punë. Nga kjo pikëpamja mund t'i quash agjentë. Atashu ushtarak është zyrtar. Ky është si një gjest që 'ne e përzumë atashen dhe nuk duam të kemi më marrëdhënie me Rusinë". Kështu mendoj unë. E mira do të ishte që të kishte një bashkëpunim mes institucioneve që gjithçka të bëhej më e pjekur dhe më e arsyeshme", - theksoi z.Klosi.

"Nuk është problemi i numrit, por i mesazhit. Me këtë që bëjmë japin mesazhin se Shqipëria është anëtare e devotshme e NATO".

Ambasadori rus në Tiranë, i indinjuar

Dëbimi i diplomatëve, Karpushin: Dëmton marrëdhëniet tona. MPJ akuzoi pa prova

Ambasadori i Rusisë Anë Tiranë, Alexander Karpushin, shprehu dje indinjatën e tij në lidhje me largimin e dy diplomatëve rusë nga Shqipëria. Sipas tij Ministria e Jashtme ka vepruar jashtë rregullave diplomatike, pasi ka publikuar emrat e diplomatëve të larguar. Karpushin deklaroi dje për News 24 se për fat të keq, dëbimi i diplomatëve dëmton marrëdhëniet mes dy vendeve. Diplomati rus përmendi se Ministria e Jashtme lëshoi një deklaratë pa pasur prova dhe për më tepër quan një gabim të madh publikimin e emrave të dy diplomatëve rusë të dëbuar. "Dëbimi i diplomatëve nuk ka qenë i detyrueshëm për asnjë vend dhe as për Shqipërinë. Për ne mbështetja ose jo e këtij vendimi është një indikator i qasjes objektive dhe gjykimit të shëndoshë të një vendi, por edhe të sovranitetit real të këtyre vendeve. MEPJ në Shqipëri lëshoi një deklaratë në të cilën pa pasur asnjë provë e akuzoi Rusinë si një sulm kimik të zhvilluar kundër Britanisë, ndërsa tani pala shqiptare dëbon dy diplomatët tanë, madje në kundërshtim me gjithë praktikën e gjithë



Ambasadori i Rusisë në Tiranë, Alexander Karpushin

AMBASADORI

"Dëbimi i diplomatëve nuk ka qenë i detyrueshëm për asnjë vend dhe as për Shqipërinë. Për ne mbështetja ose jo e këtij vendimi është një indikator i qasjes objektive dhe gjykimit të shëndoshë të një vendi, por edhe të sovranitetit real të këtyre vendeve".

pranuar ndërkombëtare. MEPJ i ka bërë publike emrat e dy diplomatëve, një gjë e tillë është e pa lejueshme dhe na ka krijuar një indinjatë të fortë. Shpjegojmë të dëgjojmë një shpjegim zyrtar të ministrisë", -tha Karpushin.

do nuk mohoi dhe as pohoi ekzistencën e këtij raporti. Helidon Bendo është pyetur në mbledhje edhe për lidhjet e politikaneve me 613 kg ko-

kainë të kapur në Durrës si dhe drogat e tjera, por nuk i ka dhënë përgjigje të drejtpërdrejtë kësaj pyetje duke u shprehur se sfida me narko-

tikët. Mësohet se Bendo është shprehur para anëtarëve të komisionit të sigurisë se sfida me narkotikët është prioritet.

RAPORTET ME GREQINE REAGIMET

Sourani: U hapëm dyert shqiptarëve në '91, më e pakta prisnim miqësi

Ambasadorja greke: Koha të varrosim paragjykimet false mes dy vendeve

Kodheli: Ligji i Luftës ka ndikuar negativisht



Gjatë një seance parlamentare

Darina Tanushi

Ambasadorja e Greqisë në vendin tonë, Eleni Sourani i ka kujtuar Shqipërisë vitin 1991. Gjatë diskutimit në konferencë ambasadorja, në lidhje me marrëdhëniet mes dy vendeve, tha se Greqia ishte vendi i parë që i hapi dyert shqiptarëve, duke i ofruar një jetë të re. Gjithashtu, në këtë konferencë të organizuar nga Instituti Shqiptar e Studimeve Ndërkombëtare dhe Fondacioni Friedrich Ebert me temë "Rishqyrtimi i marrëdhënieve Shqipëri-Greqi, sfidat e së ardhmes", ambasadorja Eleni Sourani tha: "Është koha e duhur për ta ndërruar faqen, perceptimet false dhe paragjykimet pa bazë duhen varrosur. Ne jemi dy shtetet, me identitetet kulturor historik të veçantë". Nga perspektiva jona në 1991 Greqia, duke qenë i vetmi antar edhe BE, edhe në NATO u përball me sfida për të mbështetur fuqitë në udhëtimin e tyre të vështirë të ndërtimit institucionit demokratike. Në lidhje me Shqipërinë në veçanti, Greqia ishte shteti i parë, i cili ofroi mbështetje të madhe si materiale edhe politike në vitet e vështira të tranzicionit. Ka qenë investitori më i madh i huaj, që hapi dyert e tij për qindra mijëra shqiptarë të huaj, një jetë të re atje duke ofruar qindra miliona euro në zhvillim dhe asistencë humanitare dhe mbështetjen çdo hap të procesit të integritimit euroatlantik", -tha Sourani. "Shumë qartë, më e pakta që Greqia mund të priste nga partnerët e saj ishte një miqësi e sinqertë dhe respekt për angazhimet e përbashkëta. Nuk është një surprizë që mos implementimi i një sërë marrëveshjeve bilaterale të nënshkruara mes dy shteteve ka lënë një shije të hidhur nga pala greke. Gjithsesi është koha e duhur për ta ndërruar faqen. Perceptimet false, stereotipet jo të sakta dhe paragjykimet pa baza duhet të varrosen njëherë e mirë", - u shpreh ambasadorja e Greqisë. Nga ana e saj, edhe kryetarja e Komisionit parlamentar të Politikës së Jashtme, Mimi Kodheli u shpreh se marrëdhëniet Shqipëri-Greqi janë në rritje pozitive për shkak të asaj që është cilësuar si "politika e hapave të vegjël". Nga këndvështrimi politik, marrëdhëniet mes dy vendeve, tha Kodheli, mund të konsiderohen si shumë të mira dhe në proces përmirësimi të mëtejshëm. "Ato kanë një rëndësi strategjike për ne. Greqia është pjesë e katërkëndëshit

strategjik së bashku me Italinë, Austrinë e Turqinë. Ajo është një partner e mirë dhe bashkëpunuese në

NATO. Ka qenë dhe vazhdon të jetë një vend mbështetës i Shqipërisë në proceset e saj integruese në BE", - tha ajo.

Nga pikëpamja ekonomike dhe tregtare, Kodheli theksoi se, "Greqia është investitori i huaj kryesor i Shqipërisë dhe partneri i dytë tregtar më i madh". "Negociatat midis të dy qeverive vazhdojnë për të zgjidhur çështjet e mbetura pezull, të ndara në tre shtopa, disa të trashëguara nga e shkuara, por që ndikojnë në tashmen dhe projektohen në të ardhmen e kombeve tona", tha ajo. Duke iu referuar ligjit të luftës, Kodheli tha se, "ai ka kontribuar negativisht jo vetëm në krijimin e paragjyimeve dhe ndjenjave të këqija, por edhe në çështje ekonomike dhe ato të pronave".



Presidenti, thirrje investitorëve maltezë të vijnë në Shqipëri

Illir Meta në Maltë: Komision të përbashkët për bashkëpunim ekonomik

Gjatë vizitës së tij në Maltë, Presidenti i Republikës Ilir Meta u prit në një takim nga kryeministri i Maltës, Joseph Muscat. Presidenti Meta dhe kryeministri Muscat vlerësuan marrëdhëniet shumë të mira mes dy vendeve në këtë përvjetor të 45-të dhe nënvizuan mundësitë për t'i intensifikuar më tej ato, veçanërisht në fushat ekonomike dhe kulturore. Presidenti Meta theksoi se Malta mbetet një mbështetëse e fortë e perspektivës europiane të Shqipërisë, duke shprehur besimin se përkrahja e saj nuk do të mungojë dhe procesin e rëndësishëm të shumëprurit të çeljes së negociatave të antarësimit me Bashkimin Evropian. Presidenti Meta shprehur interesin për forcimin e bashkëpunimit ekonomik,



duke nisur sa më shpejt të krijimin e komisionit të përbashkët për bashkëpunim ekonomik, me fokus sektorët si turizmi, energjia, infrastruktura, sektori financiar, teknologjia e informacionit, industria detare dhe logjistika portuale etj. Presidenti Meta ftoi kompanitë malteze të eksplorojnë potencialin investues të Shqipërisë, e cila mund të shërbejë edhe si një portë hyrëse për zgerimin e biznesit së

tyre në rajonin e Ballkanit. Presidenti Meta u takua edhe me Kryetarin e Parlamentit të Maltës, Anglu Ferrugia, të cilit i shprehur dëshirën për të thelluar kontaktet dhe bashkëpunimin ndërmjet dy parlamenteve.

LIGJI I LUFTËS

"Çështja e të Drejtave të Njeriut e popullsisë Çame dhe pasardhësve të tyre lidhet, gjithashtu, me të. Prandaj, për të hapur një faqe të re të marrëdhënieve tona, Dekreti Mbretëror i 1940, duhet të shfuqizohet së bashku me efektet e tij. Ne sot jemi të gjithë të lumtur që mësojmë se ky 'Ligj Luftë' idiot është bërë pjesë e negociatave që po zhvillohen midis qeverive tona me synimin që të shfuqizohet", - tha dje, Kodheli.

Ministri i Jashtëm grek, Kotzias të enjten në Tiranë, takon Bushatin

Ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias, do të takojë të enjten, në Tiranë homologun e tij shqiptar, Ditmir Bushati. Ministri grek e ka organizuar këtë takim, ndërkohë që do të shkojë në Vjenë, ku të premtën do të takohet me homologun maqedonas Nikola Dimitrov dhe negociatorin e OKB-së për çështjen e emrit, Matzhev Nimetz. Në fakt, për këtë takim kanë shkruar mediat greke dhe nuk ka pasur asnjë njoftim nga pala shqiptare. Delegacioni grek, mësohet se do të bëjë një ndalesë gati 3 orësh në aeroportin e Rinasit, për t'i dhënë kohë ministrit Kotzias të bisedojë me ministrin shqiptar Bushati, i cili tashmë ka marrë autorizimin nga Presidenti i Republikës për nisjen e negociatave me palën greke.

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Përmbaruesi gjyqesor privat Ermir Godaj zhvillon ankandën për shitjen e pasurisë së paluajtshme "Apartamenti" me Nr. Pasurisë 477+1-7, Zona Katedrale 8210, Vol.4, Faqe 163, me sip. 63 m², të ndodhur në Tiranë, Rr.Kongresi i Përmëtit, Pall.85, Shk.1, Ap.7, për shlyerjen e detyrimit në favor të kreditorës Valbona Janilli, në shumën 3'156'480 (tre milion e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë.

Cërimi fillestar me të cilin fillon ankandën është në shumën 6'480'000 (gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë, e përcaktuar në vendimin gjyqësor.

Ankandë zhvillohet në datë 11.04.2018, ora 16.00 në zyrën e përmbaruesit gjyqesor privat Ermir Godaj, Rruga Abdi Topani, Qendra Torre Drin, K.L2, Nr.33, Tiranë, dhe për informacion mund të kontaktoni në nr.0682099471,0684054605, email : ermirgodaj@zyrapermbarimit.com.

SCPA PROGRAM

FORCIMI I POLICIMIT NË KOMUNITET NË SHQIPËRI

Thirrje për projekt-propozime

"Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri", program që financohet nga Qeveria Suedeze dhe që asiston zbatimin e reformës së policimit në komunitet në Shqipëri, sipas **Thirrjes Nr.2 Për Aplikime**.

Organizata Joffitprurëse (OJF), konsorciume dhe Organizata me Bazë Komunitare të cilët dëshirojnë të aplikojnë për grante nën Skemën e Grantëve të Këty Programi, janë të ftuar të paraqesin projekt-propozime në kuadër të Thirrjes Nr. 2, e cila do zbatohet në qarqet Tiranë, Elbasan, Kukës dhe Gjirokastrë. Inkurajohen të aplikojnë organizata me seli në zonat ku parashikohet të zbatohet thirrja dhe projekt-propozimet të përfshijnë jo vetëm Bashkë Gendër Oarku (Tiranë), Elbasan, Kukës dhe Gjirokastrë por edhe bashkitë e tjera përberëse (psh. Kavajë, Tropojë, Gramsh etj.), apo njësitë administrative të tyre.

Për organizatat të cilat nuk kanë seli në këto zona, si kusht detyrues për aplikim në këtë thirrje, është bashkë-apikimi me një organizatë lokale/fakivistë lokale duke nënshkruar paraprakisht një marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e projektit.

Programi do të ofrojë tre lloj grantesh:

- Grante deri në **15,000 €** (3 grante për qarqet Elbasan, Kukës dhe Gjirokastrë dhe grante deri në **10,000 €** (4 për qarkun Tiranë) do të jepen për projekt-propozime që synojnë a) fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile për të mbështetur krijimin dhe ngritjen e kapaciteteve të koalicionëve me bazë komunitare me synim përmirësimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit e vazhdueshëm mes Policisë së Shtetit dhe aktorëve të tjerë lokalë, anëtarë të mekanizmave lokale të referimit, për rritjen e cilësisë së masave parandaluese dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Atati kohor për zbatimin e projektit: deri në 18 muaj
- Grante deri në **5,000 €** (nga 2 grante për qarqet Elbasan, Kukës dhe Gjirokastrë dhe 3 për qarkun Tiranë) do të jepen për projekt-propozime që synojnë krijimin dhe konsolidimin e partneriteteve ndërmjet policisë, institucioneve vendore dhe komuniteteve duke pasur në fokus rritjen, si iniciativat në fushën e zgjidhjes së konflikteve, ndërgjegjësimin, pasojat e përdorimit të drogave dhe substancave narkotike, sigurinë në trafikun nreg, bulizimin dhe krimin kibernetik, trafikimin e qenieve njerëzore, krimet homologjike, ekstremizmin e dhunshëm, etj, me theks të veçantë në masat parandaluese. Atati kohor: deri në 7 muaj

Projekt-propozimet duhet të plotësohen sipas Formularit të Aplikimit dhe Udhëzuesit për Aplikime. Të dy këto dokumente mund të konsultohen / shkarkohen nga linku: <http://www.cp-project.al/skema-e-grantëve/>. Aplikimi dhe dokumenti mbështetëse duhen dorëzuar deri në datën **22 Prill 2018, ora 17:00**. Për më shumë detaje referohuni në: <http://www.cp-project.al/>



Kreu i PD takon studentët e Shkencave Politike, zbardh planin për ndryshim

Reforma, Basha: Konsultim i gjerë për kandidatët për deputetë

"Njerëz të përkushtuar ndaj fateve të qytetarëve"

Valentina Madani

Kreu i PD-së, Lulzim Basha priti dje mbi 70 studentët të Shkencave Politike në selinë e PD-së. Për rreth një orë, z.Basha, bashkëbisedoi me studentet e Universitetit të Tiranës, dega Shkenca Politike, të cilët i drejtuan atij pyetjet dhe mendime. Për Lulzim Bashën, problem thelbësor i këtij sistemi politik të dështuar janë modelet e krijuara. Në nisje të fjalës së tij, Basha, e konsideroi ardhjen e të rinjve në një moment të veçantë në PD, atë të riorganizimit të brendshëm të PD-së. "Ne po përgatitemi për transformime në PD, jo thjesht për nevojat e brendshme. Kush janë problematikat kryesore e vendit, është korrupsioni, krimi, varfëria, por këto janë arsyeja të një sistemi të falimentuar, as të aftët, të talentuarit, me ide nuk çajmë dot përpara pa një mik të pushtetarët. Prandaj ne do të bëjmë që të zgjedhurit të jenë produkt direkt i vullnetit të anëtarëve të PD, duke e bërë PD një parti totalisht të vlerave dhe modelit evropian ndërtojmë një garanci për betejat që kemi përpara" - theksoi z.Basha. Në mënyrë të veçantë kreu Basha i njohu të rinjtë me faktin që Partia Demokratike do të bëjë reformë të brendshme për përzgjedhjen e kandidatëve për deputetë. Kreu i PD-së, Lulzim Basha i është përgjigjur pyetjes së studentëve për listat e hapura. "Sistemi zgjedhor duhet ndryshuar në pikëpamjen time, sepse ky që kemi ka dështuar, ka dështuar jo vetëm për zgjedhje të lira e të ndershme dhe që rezultatin e ndikon paraja, po se shumica e shqiptarëve nuk njohin më kush është deputeti që përfaqëson në parlament, dhe që i shërben kryeministrit kur është në manxhorancë, se si bëhet kjo me lista të hapura, sistem manxhoritar etj., çështje konsensusi mes forcave politike. Për sa i përket përzgjedhjes së kandidatëve për deputetë, PD-ja do të kryejë reformë të brendshme që do të çojë konsultim më të gjerë dhe hapjen më të madhe për këdo që ka interes dhe kualifikime të shërbejë si kandidat për deputet të PD-së. Ajo



KANDIDATËT

"PD-ja do të kryejë reformë të brendshme që do të çojë konsultim më të gjerë dhe hapjen më të madhe për këdo që ka interes dhe kualifikime të shërbejë si kandidat për deputet të PD-së. Ajo që unë dua të shoh, është një PD me rregulla loje europiane që zbatohen në mënyrë europiane. Produkti që dua të shoh është njerëz të përkushtuar ndaj fateve të qytetarëve", - tha z.Basha.

FTESA

KQZ ka ftuar ekspertët kontabël të licencuar, që të shprehin interesin e tyre pranë këtij institucioni, për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit. Data 8 prill është afati i fundit ku çdo ekspert kontabël që plotëson kriteret, të aplikojë pranë KQZ.



Pasuria, Berisha: Çifti Rama nuk tregoi asnjë faturë

Ish-kryeministri Sali Berisha deklaroi dje se "Pasuritë e pajustificuara të gjykatësit Lulo nuk janë as çereku i pasurive të pajustificuara të Edvin Krista Ramës dhe zonjës së tij të ndëruar Linda Rama". Berisha bën krahasim me bashkëshorten e kryeministrit Rama, zonjën Linda Rama, e cila para disa kohësh u akuzua për një vilë 5 katëshe në mes të Tiranës dhe një dhuratë nga e motra e saj 100 milionë eurosh. "Në 2010 Edi Rama deklaroi si pasuri të vetme 3 mijë euro dhe veten si i pastrehë. Në 2013, ai ndërton sarajet në Surrel me gjatësi themelesh 58 m ndërkohë që pallati ku banoj unë dhe 70 familje të tjera ka gjatësi themelesh prej 46 m. Rama në formularin e tij të pasurisë ka deklaruar se 5,000 m2 tokë truall të sarajeve të tij i ka blerë me 2 dollarë m2 ndërkohë që çmimi në atë zonë, sipas hipotekës, në vitin që e ka blerë Rama tokën ka qene 30 dollarë m2. Po Rama, përveç sarajeve të Surrelit, ka ndërtuar në fshetësi të plotë afër Kryegjyshitës, studion dy katësh me sipërfaqe rreth - 600 m2 me furra qeramike dhe furra shkrirese artistike metale dhe deri tani nuk ka deklaruar asgjë për paratë e blerjes së truallit, ndërtimit të studios dykatësh, furrave speciale të qeramikës dhe shkriresë artistike", -shprehet z.Berisha. Por sipas tij krahasimi i pasurive, jo vetëm të Ramës, por edhe të bashkëshortes me ato të gjykatësit Lulo, është i frikshëm! "Linda Rama në formularin e parë të pasurive deklaroi: një dhuratë me motrën e vet për 100 milionë lekë, pa treguar burimin e dhuratës fabuloze ndërkohë që motra e gjykatësit Lulo është ndërtuese e mirënjohur në Tiranë dhe zj. Linda Rama nuk deklaroi asnjë fjalë për pallatin 5 katësh me sipërfaqe ndërtimi 960 m2, të ndërtuar në mes të Tiranës, në sheshin rekreativ në mes pallateve", -tha z.Berisha.

KQZ: Partitë të dorëzojnë raportet financiare, ose gjobë

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, iu bëri thirrje partive politike që të dorëzojnë raportet financiare vjetore për vitin 2017. Në një deklaratë për mediat, zëdhënësja Drilona Hoxhaj tha se rezultat që nga 128 parti politike, deri tani e kanë dorëzuar raportin pranë KQZ-së vetëm 18, ndërkohë që afati përfundimtar është data 31 mars. "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i vendosur të respektojë ligjin, ndaj ju kujtojmë se afati për dorëzimin e raporteve financiare është data 31 mars 2018 dhe shkelja e afatit të dorëzimit të raportit financiar në kohën e duhur apo paraqitja e tyre në shkelje të formateve të standardizuara, të miratuara nga KQZ, në zbatim të nenit 23/4 të ligjit "Për partitë politike", dënohet me gjobë nga 50.000-100.000 lekë", -thuhet në njoftimin e KQZ. Ndërkohë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka ftuar ekspertët kontabël të licencuar, që të shprehin interesin e tyre pranë këtij institucioni, për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit. Data 8 prill është afati i fundit ku çdo ekspert kontabël që plotëson kriteret të aplikojë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.



'Ministrat të na japin llogari', Vokshi i dërgon letër Ramës dhe Ruçit

Kryetarja e Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Komunikimit Albana Vokshi i është drejtuar dje me një letër kryeministrit Edi Rama dhe kryetarit të Kuvendit Gramoz Ruçi, ku kërkon, që t'i jepet fund refuzimit, sipas saj, të përsëritur nga ministrat e qeverisë, që të japin shpjegime dhe informacione për veprimtarinë e tyre. Në letër deputetja demokrate argumenton se vetëm në dy muaj ministria e Kulturës dhe ministria Arsimit, kanë refuzuar komisionet parlamentare në më shumë se 8 raste për të dhënë shpjegime për vendimmarrje të ndryshme. "Ky refuzim i heq mundësinë e kontrollit kushtetues opozitës, gjë që është goditja më e rëndë e demokracisë në vend dhe përpjekje për të eliminuar opozitën" - shprehet Albana Vokshi në letër, e cila i është bërë e ditur dhe Shteteve të Bashkuara, Bashkimit Europian dhe OSBE.

që unë dua të shoh, është një PD me rregulla loje europiane që zbatohen në mënyrë europiane. Produkti që dua të shoh është njerëz të përkushtuar ndaj fateve të qytetarëve. Natyrisht sa më shumë të rinj dhe të reja" -tha Basha. Ai shtoi më tej se dhe "zërat kundër tij" në PD-në i ka ftuar edhe publikisht dhe individualisht që të bashkohen drejt një përgatitje për "përballje vendimtare me të keqen që sundon vendin". "I kam ftuar

publikisht, individualisht në të gjitha format e mënyrat dhe ftesa është e singërt. Jam i bindur që PD do shkojë përmes bashkimit drejt një përgatitje për përballje vendimtare me të keqen që sundon sot vendin. Detyra sot nuk është vetëm elektorale, po të mbrojmë vlerat ekzistenciale të shoqërisë", -theksoi z.Basha. Kreu i opozitës përsëriti thirrjen ndaj kritikëve të lidhshimit të tij, për bashkim rreth vlerave të Partisë Demokratike.

Ambasadorja e BE-së, me mision faktmbledhës për pronat në Vlorë

Vlahutin: Reforma në prona me rëndësi, do gjejmë zgjidhje

PREMTIMI

"Pas reformës në drejtësi, çështja e pronës është mjaft e rëndësishme për shqiptarët, pasi prej më shumë se 27 vite ka ndikuar në shoqërinë shqiptare. Ne si BE duam të angazhohemi për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme lidhur me çështjen e pronës private", tha Vlahutin.

e pronës është mjaft e rëndësishme për shqiptarët, pasi prej më shumë se 27 vitesh ka ndikuar në shoqërinë shqiptare. Ne si BE duam të angazhohemi për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme lidhur me çështjen e pronës

private", tha Vlahutin. "Për mua dhe për BE ky është një udhëtim fakt mbledhës. Duam të flasim me gjithkënd që në një mënyrë ose në një tjetër ka lidhje me çështjen e pronës. Me institucionet administrative dhe po-

licinë, me prokurorinë, gjykatat, por për ne thelbësore ishte takimi me qytetarët", tha ambasadorja. Sipas saj, "pas reformës në drejtësi, kjo është reforma tjetër më e rëndësishme për shqiptarët". "Do të kemi takime të ngjashme në bashki të tjera të vendit dhe së bashku me Ministrinë e Drejtësisë do të gjejmë një mënyrë për të ndihmuar për të analizuuar situatën pikësepári nga këndvështrimi ligjor dhe nga përvoja të ndryshme që kanë pasur njerëz-



Ambasadorja e Bashkimit Europian, Romana Vlahutin

it. Dhe të gjejmë më pas zgjidhjen më të drejtë që do të respektojë dhe mbi të gjitha të drejtën e pronësisë. Ka një problem me ish-pronarët, që për 27 vjet nuk regjistrojnë prona që të afërmit e tyre i kanë pasur për 300 vjet. Dhe kjo është pika nga do të fillojmë", tha am-

basadorja. Ministria Gjonaj deklaroi se, "së fundi janë zhvilluar një sërë veprimesh ligjore dhe administrative lidhur me çështjen e pronës, ku edhe sot në takimet që do të kemi me administratën e dy agjencive kryesore të pronave do të nxjerrim shumë problematika".

Kryeministri bashkëbisedon me fermerët në Polis: Bashkoni idetë

Rama, fermerëve: Po përgatisim "pronësi" për ata që kanë punuar tokën shtetërore

"Aplikoni me projekte të qarta për financim"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama u bëri dje thirrje fermerëve në Polis të Librazhdit të bashkojnë forcat për të pasur sukses në punën e tyre. Gjatë një bashkëbisedimi me banorët e zonës, Rama u shpreh: "Kemi kohë që flasim për domosdoshmërinë e bashkimit të forcave. Natyrisht që kur ne e themi këtë, shumëkush mendon se bëhet fjalë për t'u kthyer në të shkuarën dhe disa që janë mësuar të flasin shumë e për lumë akuzojnë se po bëjmë thirrje për të kthyer të shkuarën. E vërteta është se kudo ku ka sukses sot në Shqipëri, sukcesi është rezultat i bashkimit. Kudo ku ka sukses sot në fshat, sukcesi nuk është personal, individual, i shkëputur nga ndërveprimi me të tjerët. Kjo nuk do të thotë që 'hajde të bashkojmë tokat'. Kjo do të thotë të bashkojmë mendjen dhe të bashkojmë forcat. Secili në tokën e vet, secili në ato dynmë apo hektarë që ka, as më shumë, as më pak, por ama me një ndërveprim dhe një vendim-marrje, çfarë do prodhojmë dhe do e shesim së bashku, sepse nëse jemi të ndarë, 2 dynmë apo hektarë këtu e 3 atje, jemi pre e grosistëve që vijnë dhe ose na e marrin për 5 lekë, ose nuk na e marrin fare. Apo më keq akoma, jemi pre e paditurisë me prodhime që na ngelen nëpër shtëpi dhe kalben e hidhen në lumë", sqaroi kryeministri Rama. Duke i ftuar fermerët të aplikojnë për mbështetje nga fondet e BE apo të qeverisë, Rama tha: "Nuk do të ketë përgjigje me parti, nuk do të ketë përgjigje me rryshet, por do të ketë përgjigje në bazë të aftësisë që do tregojë vlerën e një aplikimi, apo të një aplikimi tjetër, me kritere shumë të qarta dhe shumë transparente. Ne



Kryeministri Edi Rama me fermerët në Polis të Librazhdit

duam që këto para të mund t'i thihim të gjitha dhe të bëjmë sukses. Bashkimi Europian vërtetë jep lekë, por lekë qyl nuk ka. Që t'i marrësh ato para dhe t'i përdorësh, do të thotë të kesh një projekt shumë të qartë dhe duhet të kesh argumente të plota për të marrë financim. Është shtyrë një muaj aplikimi për agroturizmin, sepse ka interesim dhe në fakt, ne kemi qenë pak më të vonuar në kohë, sepse është një program i ri i qeverisë së re. Nuk ka qenë në qeverisje e shkuar: Kështu që kemi lënë edhe një muaj këto, që kush ka një strukturë që do ta kthejë në agroturizëm, që do të thotë do ta kthejë në bujtinë, në një fermë të vogël me produkte blegtorale, me një kuzhinë në dispozicion të miqve që vijnë, të ketë

mundësi të aplikojë", informoi Rama. "Shteti nuk është sot ai që ishte dikur, që të vinte pushkën pas veshit e të thoshte dorëz tokën në kooperativë dhe hajde se do bëjmë kooperativën, futi të gjithë kashfët në kooperativë dhe hajde puno skllav në kooperativë. Sot është vullneti dhe forca e mendjes suaj dhe e të gjithë atyre që janë në punë me tokën, që t'i thonë tjetrit: po të jemi të ndarë, jemi keq; po u bashkuam, bëjmë sukses, bëjmë pasuri dhe i japim fund njëherë e

mirë zvarritjes në varfëri e në lëmoshë", u tha Rama fermerëve. Rama njoftoi se për ata që kanë mbjellë në toka shtetërore po përgatitet që t'u jepet në përdorim atyre që e kanë punuar. "Po përgatitet një formë pronësie, marrje në përdorim, nuk e di me saktësi sot ta them, - por po punojmë që t'i njihet e drejta atyre që i kanë mbjellë, që i punojnë, i kultivojnë dhe jetojnë, sepse në fund të fundit, këtë po kërkojmë dhe ne", tha Rama.

SHKURT

Referendumi për mbetjet, PD: PS po kërkon t'i rikthejë plehrat

Socialistët u shprehën dakord me nismën e demokratëve për të mbajtur një referendum për importin e mbetjeve në Shqipëri, por ata kërkojnë konsultime me komisionet parlamentare. Për deputetët e opozitës, kjo është një përpjekje për të bllokuar procesin. Komisioni i Ligjeve nisi dje shqyrtimin e kërkesës së demokratëve për referendum popullor për plehrat, 6 muaj pas depozitimit të sa në Kuvend. "Jemi para një risku shumë të lartë, që mazhoranca të rikthejë importin e mbetjeve kundër vullnetit të publikut", u shpreh Oerd Bylykbashi. Relatori socialist, Bledi Çuçi theksoi se nisja e demokratëve është konform Kushtetutës dhe ligjeve, por ngriti disa pikëpyetje të tjera, për të cilat kërkoi konsultim me Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese. "Shtrohet pyetja nëse çështja për të cilën kërkohet referendum: A është e një rëndësie të atillë për ta çuar në referendum? A ekziston një çështje? Për këto dy çështje duhet të marrim përgjigje nga komisioni përgjegjës që ka të bëjë drejtpërdrejtë", tha Çuçi.

Deputetja e PD-së, Dhurata Çupi zgjidhet kryetare e Aleancës së Grave

Aleanca e Grave deputete zgjodhën dje strukturën drejtuese, ku kryetare u zgjodh znj. Dhurata Çupi, zëvendëskryetare u zgjodh znj. Elona Gjëbrea dhe sekretare u zgjodh znj. Silva Caka. Kryetarja e Aleancës së Grave Deputete, znj. Dhurata Çupi në fjalën e saj pas zgjedhjes si kryetare falënderoi deputetët për mbështetjen e dhënë, duke shtuar se ky forum do të qëndrojë larg ndikimeve politike. Zëvendëskryetarja, znj. Elona Gjëbrea u shpreh se kjo do të jetë një aleancë aktive. "Ju falënderoj për mbështetjen dhe jam e bindur që do të jetë një aleancë aktive në mbështetje të grave, në mbështetje të grupeve që kanë nevojë në bashkëpunim me partnerët dhe shoqërimë civile në përmbushje të të gjitha rezo-lutave dhe detyrimeve që ne kemi", - tha znj. Gjëbrea.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
SHOQËRIA PËRMBARIMORE "EXECUTORËS LITUM" (EX-LIT) sh.p.k

Shoqëria Përmbarimore "Executores Litum" sh.p.k do të zhvillojë ankandin e pare për pasuritë e palajshme:

Trulli me nr pasurie 45/8, me sip. 4392 m2, ZK 1006, vol 01, fq.197, e ndodhur ne Ahmetqaj Tirane ne pronesi te Perit Shetqet Elezi.

Çmimi me te cille dhe te flligje ankandi eshte ne vleren 112.008 Euro

Ndertes me nr. pasurie N45/8, me sip. 1167 m2, ZK 1006, vol 9, fq.197, e ndodhur ne Ahmetqaj Tirane ne pronesi te Perit Shetqet Elezi, Altin Derivishi, Emri Stafaj.

Çmimi me te cille dhe te flligje ankandi eshte ne vleren 208.572 Euro

Ankandi do te zhvillohet ne date 06.04.2018 ora 16:00, ne zyren permbarimore "Executores Litum" sh.p.k, me adrese Blv "Zhan Dark", Kulla 1 Teknoprojekt, shk 1, kati 4, ap 10, Tirane.

Ministri i Financave: OSHEE, agjent më i mirë. Bashkitë, të drejtë për reduktim deri në 30 për qind

Taksa e pronës, Ahmetaj: Nga 1 prilli, me faturën e dritave

Debatet në Komisionin e Ekonomisë për taksën dhe TVSH-në

Ornela Manjani

Nga data 1 prill hyn në fuqi një ndryshim i rëndësishëm i taksës, që prek familjarët. Kjo është taksa e pronës, që nuk do të paguhet më si fikse mbi metër katrorë, por do të jetë sa 0.05% e vlerës së shtëpisë. Taksa do të shkojë në çdo shtëpi me faturën e energjisë elektrike. "Kjo është takse selektive, sepse hoteli 1 përjashtoni, ndërsa familjarët do ta paguajnë. Për disa raste, taksa për familjet rritet nga 2 deri në 4 herë" - tha deputetja e opozitës, Jorida Tabaku. Ministri i Financave, Arben Ahmetaj u përgjigj se kjo takse nuk rritet aq sa pretendon opozita. "Më gjeni një rast ku rritet aq. Po të marr një shtëpi 70 metër, do të paguajë vetëm 102 lekë në muaj", - tha Ahmetaj. Gjatë raportimit në Komisionin parlamentar të Ekonomisë, ministri i Financave, Arben Ahmetaj iu përgjigj interesimit të deputetëve lidhur me skemën e re të mbledhjes dhe përlogaritjes së taksës, duke theksuar se impakti në buxhetet familjare do të jetë minimal. Sipas Ahmetajt, njësitë e pushtetit vendor kanë mundësinë që të reduktojnë deri në 30% të taksës dhe kjo mund të ulë edhe më tej ndikimin në buxhetet familjare.

GRUPET QË TAKSOHEN

Taksapagues është çdo individ, person fizik ose juridik, vendës ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë,



Ministri i Financave, Arben Ahmetaj

PAGESAT PËR SHTËPI E BIZNESE

Për efekt të llogaritjes së taksës për ndërtesën/njësi pronësore, baza e taksës shumëzohet me shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj, sipas kategorive të ndërtesave:

- 0,05%, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim.
- 0,2%, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike.
- 30% e shkallës së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave. Detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" e kanë, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me doku-

mente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse të lëshuar nga njësi e vetëqeverisjes vendore. Përcaktimi i vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore bazohet mbi pri-

oritetet e vlerësimit, duke ndjekur një radhë të caktuar. Baza e vlerësimit mbështetet të vetëdeklarimi, si një detyrim për çdo taksapagues për të vijuar më tej edhe me metodat alternative, nëse vetëdeklarimi nuk bëhet, nuk është i saktë apo nuk disponohen të dhëna të plota për një vlerësim të drejtë

DEBATI NË KOMISION

Erjon Braçe: Po ta them që do ta sulmoj cilindo që përdor pasurinë kombëtare të këtij vendi dhe nuk i kthen mbrapsht asnjë qindarkë nga tatimitimi, kaq.

Agron Shehaj: 142 sipërmarrës. Dhe nuk e di fare për çfarë po flisni.

Erjon Braçe: 142 se është dhe Rezart Taçi aty akoma.

Jorida Tabaku: Rritja më 1 prill e taksës së pronës bashkë edhe me rritjen e faturës së ujit me 40% për një pjesë të madhe të qyteteve shkon pothuajse me një pagë mujore për një familje të mesme.

Arben Ahmetaj: 146 lekë në muaj dhe po do një shtëpi 110 metra e re është 220 lekë në muaj, 2200 lekë të vjetra në muaj. Ku është rritja këtu?

Debate në komision shkaktoi edhe përfshirja në TVSH e bizneseve që kalojnë xhiron mbi 2 milionë lekë në vit. Sipas ministrit Ahmetaj, kjo takse nuk do të ketë në çmime edhe koston e biznesit, por ky argument nuk u pranua nga deputeti demokrat, Agron Shehaj.

Arben Ahmetaj: Nuk ka rritje taksash, ka deklarim.

Agron Shehaj: Nuk e paguan askush. Pas deklarimit ka pagesë. Nuk keni bërë ndonjëherë biznes, ke folur me biznesmenët? Lëri mashtrimet.

Arben Ahmetaj: Mos u skuq.

të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore që duhet të taksohet.

TVSH-JA

Gjatë diskutimit në Komisionin e Ekonomisë, për futjen në skemën e TVSH të bizneseve të vogla duke nisur nga 1 prilli, kreu i financave shqiptare tha se kjo do të japë kontribut në aksionin antiinformalitet. Ahmetaj tha për këtë pjesë se "ka shqyrtuar disa mënyra, mbledhja e faturave është vendosur në disa vende, por është hequr sërish. Ndërsa, 17 mijë biznese janë bërë skemë e TVSH-së", citoi ministri Ahmetaj gjatë raportimit të tij. "37 mijë biznese paguajnë 0.7% të totalit të TVSH. Nuk pritet që kontributi të jetë i lartë. Do të kenë të drejtën e kreditimit të TVSH për mallrat gjendje, si dhe njohja e TVSH e zbritshme për mallrat e inventarit. Çdo mall të jetë i justifikuar me faturë TVSH-je. Për këtë është krijuar grupi i punës. Tatimpaguesi do të njoftohet elektronikisht. Nuk do kemi asnjë problem me sistemin informatik", tregoi ministri.

United Nations Development Programme



TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: – RFP for Empowering Albanian Mayors through peer to peer exchange program

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP 45117**
RFP for Empowering Albanian Mayors through peer to peer exchange programy"

For more details please refer to the link below:
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/>

Relevant dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than **10-Apr-18**

Address for communications:
Email: procurement.al@undp.org

Or
Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor
Tirana, Albania

United Nations Development Programme



TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: – RFP to Support Improvement of Tax Collection and Enforcement for Local Self-Government Units in Albania

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP 45118**
RFP to Support Improvement of Tax Collection and Enforcement for Local Self-Government Units in Albania

For more details please refer to the link below:
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/>

Relevant dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than **13-Apr-18**

Address for communications:
Email: procurement.al@undp.org

Or
Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor
Tirana, Albania

Procedurat e aplikimit dhe dokumentet që duhet të dorëzoni

Ornela Manjani

Bashkia e Tiranës do të hapë thirrjen e dytë për familjet e reja që nuk kanë mundësi të blejnë një banesë sipas normave të interesave të tregut. Në total do jenë në dispozicion rreth 500 kredi me interesa të ulëta dhe që do mund të përfitohen nga familjet e reja që plotësojnë kriteret e përcaktuara. Bashkia e Tiranës ka përgatitur tashmë projektvendimin "Për miratimin e programit social të strehimit nëpërmjet subvencionimit të interesave të kredisë", i cili pritet të miratohet në mbledhjen e ditës së enjte në Këshillin Bashkiak.

NDRYSHIMET

Bashkia bën të ditur se janë përcaktuar tri kriteret të reja për përfituesit. Së pari, ndryshon mosha e përfituesve pasi është marrë në konsideratë fakti që disa përfitues për shkak të moshës së madhe janë penguar në klasifikimin për kredi. Tashmë mosha e çiftit duhet të jetë me moshë totale deri në 70 vjeç. Së dyti, afati subvencionimit të kredisë do të rritet nga 15 në 20 vjeç, duke bërë që kështu për një familje përfituese të jetë më i ulët dhe më i përballueshëm. Së treti, ndryshojnë edhe të ardhurat e përkohshme.

PËRFITUESIT

Përfitues potencial në programin "Subvencionimi i interesave të kredisë për familjet e reja", do të jenë familjet e reja që përbëhen nga çifti i ri me moshë totale deri në 70 vjeç. Po kështu edhe familjet e reja që kanë në ngarkim persona me aftësi të kufizuar apo persona në pension. Janë disa nga kriteret që duhet të plotësojnë ndër të cilat: Nuk kanë në pronësi një banesë, kanë të ardhura sipas limitit të përcaktuar në këtë program,

Bashkia e Tiranës hap aplikimet për 500 kredi të buta, ja kush përfiton

Ndryshojnë tri kriteret: mosha, afati dhe të ardhurat

Tabela e llogaritjes së kredisë

Struktura familjare	Struktura apartamentit	e Sip. Mes.	\$9,137		Rasti 1.1 n=20, i=3 %		Te ardhurat minimale	Te ardhurat maksimale
			Vlera Struktures	Kufiri maksimal i kredisë nga banka	Pagesat Mujore 80% vleres (3% interes)	Mujore (3%)		
1-2 persona	Gasoniere	50	4,456,850	3,565,480	19,771	43,936	79,086	
2-4 persona	1-1	60	5,348,220	4,278,576	23,726	52,724	94,903	
4-6 persona	2-1	80	7,130,960	5,704,768	31,634	70,298	126,537	
mbi 5	3-1	100	8,913,700	7,130,960	39,543	87,873	158,171	

nuk janë dhe nuk kanë qenë përfitues të programeve të tilla të ngjashme më parë. Sipas zyrës së shtypit të bashkisë, thuhet se sipas këtij projektvendimi, duke u nisur nga problematikat e hasura gjatë thirrjes së parë është parë e arsyeshme të ndryshojnë disa nga përbërësit e skemës së subvencionimit të interesave të kredisë dhe kufijtë minimal dhe maksimal të nivelit të të ardhurave që duhet të plotësojnë aplikuesit.

APLIKIMI

Në fazën e parë të aplikimit, çdo aplikant që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet që janë të regjistruara në zyrat e gjendjes civile të Bashkisë Tiranë, të cilat, në momentin e aplikimit, plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikat ligjit "Për pro-

gramet sociale të strehimit" kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për të përfituar nga programi "Subvencionimi i interesave të kredisë". Sakaq, aplikantët duhet të plotësojnë Formularin e Strehimit TIP, pranë njësisë administrative përkatese, të cilit do t'i bashkëlidhin edhe dokumentacionin si: deklaratat e vërtetësisë së informacionit të pasqyruar në formularin e strehimit, kopja e kartës së identitetit të aplikuesit, certifikata familjare. Pas plotësimit të formularit dhe dokumentacionit, njësitë administrative përkatese i përcjellin ato në Bashkinë Tiranë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social, e cila realizon procesin e seleksionimit të formularëve të vlefshëm sipas këtyre kriterëve të përcaktuar.

ara. Pas marrjes së njoftimit, familjet përfituese, dorëzojnë pranë Zyrës së Pritjes me Qytetarin në Bashkinë Tiranë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton deklarin dhe vërtetësinë e plotësimit të formularit të strehimit në bazë të të cilit janë

FAMILJET PËRFITUESE

Familjet përfituese pas marrjes së njoftimit nga Drejtoria e Strehimit, paraqesin pranë Zyrës së Pritjes me Qytetarin në Bashkinë Tiranë të gjithë dokumentacionin e kërkuar, që mbështetet në deklarin dhe bërë dhe që aprovon vërtetësinë e aplikimit të bërë në momentin e dorëzimit të formularit të strehimit pranë njësisë administrative përkatese. Pas marrjes në dorëzim të listës së inventarit, Komisioni i Strehimit, në bazë të dokumenteve të dërguara nga aplikuesit, kriterëve për përzgjedhjen e përfituesve dhe formulës së pikëzuar, shqyrton dhe vlerëson aplikimet, duke vendosur pikët për secilin aplikim.

KUFIRI I FINANCIMIT

Kufiri maksimal i kreditimit për familjet llogaritet deri në 80% të vlerës së pasurisë (bazuar tek kontrata e shitjes). Llogaritja e pagesave mujore (kësteve) është bërë, duke supozuar që interesi për kredimarrësin do të jetë në normën 3%, për një periudhë kohe 20-vjeçare.

përzgjedhur fitues. Në fazën e dytë të aplikimit, Drejtoria e Strehimit Social, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe

Jashtë shpallin njoftimin për dorëzimin e dokumentacionit që duhet të dorëzojnë individët apo familjet që kanë kaluar fazën e parë të aplikimit.

Tapi edhe për një minoren

Kreu i Hipotekës zbardh skemën: Ja si vidheshin tokat në bregdet

Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ka evidencuar një sërë abuzimesh me titujt e pronësisë. Kreu i zyrës qendrore të regjistrimit të pasurive, Elion Semanaj, thotë se janë konstatuar shkelje dhe në vendimet e gjykatave. "Mund të përmendim së pari, rastin kur me një vendim gjykatë të nivelit më të ulët është rritur sipërfaqja e pasurisë me plot 20 hektarë, kur pasuria dhe sipërfaqja janë përcaktuar dhe regjistruar më përpara me një vendim të Gjykatës së Apelit. Ky veprim është kryer në bashkëpunim me zyrën vendore, e cila nuk ka ankimmuar vendimin dhe nuk ka parqitur provat e nevojshme pranë Gjykatës Administrative të shkallës së parë. Gjithashtu, kjo ka sjellë si pasojë rritjen e sipërfaqes në favor të spekulantit duke dëmtuar rëndë interesat e shtetit" tha Semanaj në një interv-



iste për Ora News. Gjatë verifikimeve janë vërejtur abuzime edhe me rastet e marrjes së pronës në përdorim në bazë të ligjeve për ndarjen e tokave. "Gjithashtu, njësi administrative vendore ka plotësuar dhe ka konfirmuar aktin e marrjes së tokës në pronësi për një person, i cili ka qenë minoren në momentin e përfitimit të tokës bujqësore në bazë të ligjit 7501. Gjithë dokumentacioni është përcjellë si i rregull nga njësi vendore drejt zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, gjë e cila bie në kundërshtim me të gjitha aktet ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi" tha kreu i Hipotekës. Gjetjet do t'i referohen më pas task forcës së ngritur nga Kryeministria dhe në përfundim të hetimit të thelluar administrativ do t'i përcillen dhe organeve ligjzbatuese.

Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH**OPEN CALL FOR TENDER PREQUALIFICATION****1. GENERAL CONDITIONS**

- 1.1. Requester:** The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Country Office Albania in Tirana, Rr. Skenderbej, Nr 21/1.
- 1.2. Profile:** The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, is an experienced service provider and assists the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation. GIZ offers demand-driven, tailor-made and effective services for sustainable development
- 1.3. Subject:** The GIZ Office Tirana invites authorized and registered companies to express their interest in providing one off-road vehicle (4x4).
- 1.4. Companies should fulfill the following requirements:**
 - 1) Be an authorized and licensed dealer/partner from the manufacturer. According certificate must be provided.
 - 2) Provide a warranty up to 100.000 km drive for the vehicle.
 - 3) Offer quality service for the vehicle within the warranty duration. All legal entities interested in application process should ask for an application form to the address: giz-albanien@giz.de
- 1.5. Due date for submitting the application is 11.04.2018.** The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: "PROVISION OF Off-Road Vehicle (4x4)", addressed to:

German Development Cooperation Office (GIZ), Office in Tirana, Rr. Skenderbej, Nr 21/1 Tirane

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated, and only prequalified candidates will be invited to answer to the bid.

Një ish-gjyqtar është ko manduar ditën e djeshme nga ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj në krye të shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave. Konkretisht Agim Hysi do të zëvendësojë në këtë detyrë Eduart Mrekaj. Ish-gjyqtari është shkarkuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në vitin 2002. Hysi ka qenë pjesë e sistemit të drejtësisë në Vlorë dhe Gjirokastrë. Ai u lind më datë 8 qershor 1957 në qytetin e Vlorës dhe është



Ish-gjyqtari Agim Hysi

të diplomuar "JURIST" në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës viti 1984-1988. Ish-gjyqtari ka një karriere të gjatë në fushën e Drejtësisë dhe Avokatisë. Në

Ish-gjyqtari Agim Hysi komandohet drejtor i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave

vitin 1980 deri në 1984 Agim Hysi ka mbajtur postin e kryesekretarit gjyqësor i Gjykatës së Rrethit Vlorë. Më pas nga 1988 deri më 1996 ka qenë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në 1996 - 1998 Gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Në 1998 - 2002 gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Më pas

në 1995 rezultoi të ketë qenë anëtar i Shoqatës së Juristëve IBM me qendër në Londër. Për të vijuar në 1996 si anëtar i Konferencës Evropiane 'Mbi të drejtat e fëmijëve' (Bruksel 1996 e vijim). Në vitin 1996 është bërë anëtar aktiv i shoqatës "Epoch Worldwide" me qendër në Londër. Më pas në periudhën kohore 1997-2002 Ekspert, ka qenë anëtar i Ko-

mitetit të eksperteve të përzgjedhur për problemet e pastrimit të parave dhe të krimin të organizuar, pranë Këshillit të Evropës Strasbourg. Në vitin 2001 ka qenë kandidat i Republikës së Shqipërisë si anëtar i Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasbourg dhe në 2002 kandidat i Republikës së Shqipërisë, si anëtar i Gjykatës Interna-

cionale Kundër Krimeve të Njerëzimit, Hagë. Më tej në 2004-2013 Hysi rezultoi të ketë qenë anëtar i komisionit të provimit të avokatëve. Hysi ka qenë avokat pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë në vitet 2002 - 2011. Më 2014 deri në vitin 2017 rezultoi të ketë qenë avokat Shteti - Drejtues i Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Më pas në 2017 -2018 ka mbajtur postin e zv. drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

"Shkresë ONM dhe Arta Markut, procesi gjyqësor po devijohet me qëllim nga prokurorët"

'Shullazi', gjykata refuzon dëshminë e drejtorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Ardian Çipës

Avokatët: Të japë sqarime përse ka fituar mbrojtje policore Besnik Musai

Ina Allkanjari

Gjykata ka rrëzuar ditën e djeshme kërkesën për të thirrur si dëshmitar në seancën e radhës ndaj Emiljano Shullazit, drejtorin e drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Ardian Çipa. Këtij të fundit i kërkohet nga pala mbrojtëse të jepte shpjegime se pse duhet të merrte statusin dëshmitar i mbrojtur Besnik Musai, shoferi i Ylvi Beqajt, dhe njëkohësisht vëllai i bashkëjetueses së biznesmenit. Kjo pasi sipas avokatëve, Musai nuk është familjar i biznesmenit Beqaj, ndaj nuk ka arsye se përse ai të jetë person i mbrojtur nga drejtësia.

"Besnik Musai është familjar i një lidhjeje jashtëmarte-sore të Beqes dhe ligjërisht ai nuk është rreth familjar i tij", tha avokati Vladimir Meçi. Po ashtu avokatët bënë me dije se i janë drejtuar me një shkresë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe kryeprokurores Arta Marku, me pretendimin se procesi gjyqësor po devijohet me qëllim nga prokurorët. Në dëshminë e dhënë më herët shoferi personal, njëkohësisht dhe kunati i biznesmenit Ylvi Beqja e rëndoi akoma më shumë pozitën e Emiljano Shullazit dhe miqve të tij përball drejtësisë. Musai gjatë deklaratës para togave të zeza tregoi gjithçka dinte në lidhje me mosmarrëveshjet që shefi i tij Beqja kishte pasur me Shullazin. Ai rrëfeu momentin kur sipas tij Shullazi kërcënoi me armë biznesmenin pas një debati të ashpër me tyre që lidhej me pronësinë e ish-hotel "Vollgës".

DËSHMIA E MUSAIT

Gjatë seancës gjyqësore të zhvilluar në shtator të vitit që shkoi në Gjykatën e Krimeve të Rënda, Musait deklaroi se ka qenë prezent në disa raste kur Beqja ka pasur mosmarrëveshje me Shullazin dhe miqtë e tij. Ai tregoi se e ka shoqëruar Ylviun te zyra e noterisë në Durrës, për të nënshkruar një kontratë, përmes së cilës do t'i dhuronte Emiljano Shullazit një pjesë të ish-hotel "Vollgës" në Durrës. Përpara se të përfundonin procedurat sipas tij



Emiljano Shullazi

Shullazi ka dalë jashtë zyrës së noterisë dhe pas një debati të ashpër me Beqajn e ka kërcënuar duke i vënë pistoletën në bark. Dëshmitari tha më tej se kunati i tij ka komunikuar disa herë me mikun e Shullazit, Gilmando Danin, ku ky i fundit e kërcënonte duke i kërkuar shuma të mëdha parash. "Ylviu komunikonte me Gilando Danin, pasi ai i kërkonte shumat e parave. Unë isha me të në makinë dhe i dëgjoja bisedat. Në rastin e parë Ylviu shkoi t'i dorëzojë shumën prej 80 mijë eurosh Gilmando Danit, i cili e priste jashtë një lokali pranë ish-parkut të auto-

busesë në Tiranë. Unë ndenja në makinë. Ylviu hyri brenda në lokal bashkë me Gilmandon dhe ndenjen 5 minuta së bashku dhe pastaj u kthye. Vetë Ylviu më tha se e kërcënonin që t'i u jepte para. Herën e dytë, unë dhe Ylviu erdhëm nga Durrësi në Vorë, ku ai do t'i dorëzonte Gilmando Danit 70 mijë euro. Nuk i dorëzuam paratë, pasi një makinë goditi makinën tonë dhe u detyruam të shkonim në servis. Nuk di nëse këto para janë dorëzuar", pohoi Besnik Musai. Gjithashtu, gjatë dëshmisë së dhënë më herët, 27-vjeçari Musai tha përpara togave të zeza se edhe

ai vetë ka pasur probleme, pasi prindërit e tij janë kërcënuar nga dy persona të panjohur. "Familjen time në Durrës e kanë kërcënuar me jetë dhe me shpërthim të sh-

tëpisë. Mamaja ime ka parë dy djem që kanë tentuar të kalojnë avlinë. I ka pyetur se ç'kërkonin. Ata i kanë thënë: "Ti ke një djalë. Nëse ai vjen në gjyq dhe thotë

ndonjë gjë që s'duhet do t'i keni punët keq", ka deklaruar përpara togave të zeza në shtator të 2017, dëshmitari i mbrojtur nga drejtësia, Besnik Musai.

Dosja i kalon prokurorisë së Durrësit

Kokaina në Maminas, Krimet e Rënda shpallin moskompetencë

Dosja hetimore për sasinë e 613 kilo gramëve kokainë të ardhur nga Kolumbia të bllokuar në Maminas, pritet t'i kalojë prokurorisë së Durrësit. Prokuroria e Krimeve të Rënda shpalli moskompetencën e hetimit pasi dosja është regjistruar si trafik narkotikësh, dhe jo grup i strukturuar kriminal. Kjo bazuar në një vendim unifikues të Gjykatës së Lartë. Përmes këtij vendimi Gjykata e Lartë la në kompetencën e Krimeve të Rënda vetëm dosjet për veprat penale që janë në kompetencën e hetimit dhe gjykimit nga Prokuroria dhe Gjykata Speciale SPAK.



Procedimet e tjera penale, jashtë kësaj fushe, në çdo fazë të tyre, hetim apo gjykim, do t'i delegohen për kompetencë prokurorisë së Durrësit. Si rezultat i operacionit policor të koduar "Last Snow", u bënë mundur kapja dhe

sekustrimi i një sasie rekord prej 613 kg 350 gr lëndë narkotike e dyshuar kokainë, me vlerë tregu mbi 180 milionë euro. Mësohet se hetimet kanë dokumentuar se lëndë narkotike ishte nisur me kontener nga Kolumbia duke kaluar transit përmes Italisë, në Maltë e më pas me anije ka mbërritur në Portin e Durrësit në Shqipëri, më 19 shkurt të këtij viti. Sipas policisë, kokaina ishte e fshehur në kontener me dyshime të dyfishtë, të ngarkuar me banane. Operacioni ka nisur gjatë mbremjes së datës 27 shkurt 2018, në portin e Durrësit, në momentin që ngarkesa e ligjshme me banane u mor në dorëzim nga firma porositëse "Arbri Garden" shpk, me pronar shtetasin Arbër Çekaj. Ky i fundit është shpallur në kërkim, ndërsa pas hekurave janë drejtuesi i kamionit dhe menaxheri i firmës, "Arbi Garden".

51-vjeçarja nga Tirana pëson infarkt në rrugë, policia: Dhunohej nga bashkëshorti

me inicialet I.G.J., kishte dalë në rrugë dhe aty kishte humbur ndenjat, pasi kishte pësuar infarkt. Mësohet se kanë qenë kalimtarët e rasti ata që i kanë ofruar ndihmë graus, e cila u dërgua me urgjencë në spital. Bëhet me dije se mjekët kanë vënë re

hematoma të mëdha në trupit e 51-vjeçares, ndërsa rasti u referua policisë se gruaja ishte dhunuar nga burri i saj. Ndërkohë materialet u referuan Prokurorisë pranë Gjykatës Shkalles Parë Tiranë, për bashkëshortin, shtetasin I.G.J, 54

vjeç, banues në Tiranë, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë psikologjike dhe fizike ndaj shtetasës A.G.J, 51vjeç banuese në Tiranë. Sakaq nga hetimet e deritanishme rezultoi se vdekja ka qenë natyrale, pasi gruaja ka pësuar atak kardiak.



TIRANË - Një ngjarje e rëndë ka ndodhur ditën e djeshme në kryeqytet, ku një 51-vjeçare, e cila dhunohej sistematikisht nga bashkëshorti i saj, ka humbur jetën në spitalin "Nënë Tereza". Burime zyrtare nga policia e kryeqytetit bënë me dije se shtetasja me inicialet A.G.J., pas një shërimi që kishte pasur me burrin e saj, shtetasin

Agjencia e Trajtitimit të Pronave: Përfituesit kanë edhe 4 muaj kohë për të plotësuar dokumentet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtitimit të Pronave ka përfunduar procesin e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare për dosjet e vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara në të gjithë vendin. Në përfundim të procesit të verifikimit të vendimeve të administruara pranë arkivës së ATP-së, u identifikuan gjithsej 1462 vendime të vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara. Të dhënat lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuara, sipërfaqja e njohur për kompensim, vlerësimi financiar përkatës apo mangësitë në dokumentacion dhe problematikën në vlerësim jepen të detajuara për çdo dosje. Numri total i vendimeve të viteve 1993-1997, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara dhe që janë vlerësuar

Llista II/ Vendimet e vitit 1997, emrat e 1462 pronarëve që kompensohen

Kanë njohur të drejtën e kompensimit për vitet 1993-1997 rreth 17 318 vendime

financiarisht e publikuar nga ATP-ja është 17 318 vendime. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë me përfituesit e vitit 1997 së bashku me vlerën financiare.

MUNGESA E DOKUMENTACIONIT

Sipas ATP-së, në rastet kur subjektet e interesuara nuk sjellin dokumentacion të nevojshëm për vlerësimin financiar të vendimit të kompensimit brenda afatit 6-mujor nga data e publikimit të regjistrimit, si dhe në rastet

kur ATP-ja është në pamundësi objektive për të vlerësuar pronën, bazuar në dokumentacionin që disponon vendimi i kompensimit vlerësohet financiarisht. Pronarët kanë edhe 4 muaj kohë për plotësimin e dokumenteve dhe ATP njofton të gjitha subjektet, që për çdo informacion apo paqartësi lidhur me të dhënat e publikuara në regjistrë apo që nuk i gjejnë të publikuara në të, mund të paraqiten pranë sporteleve tona për sqarime dhe informacion

më të detajuar. Gjithashtu, ATP ka filluar punën dhe së shpejti do të përfundojë procesin e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare të vitit 1998 dhe në vijim sipas rendit kronologjik do të vlerësohen të gjitha vendimet, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

DOSJET E PËRFUNDUARA

Me përfundimin e procesit të vlerësimit financiar të

vendimeve përfundimtare të vitit 1997, si dhe nga përditësimi i regjistrimit të vendimeve për vitet 1993-1996, numri total i vendimeve të viteve 1993-1997, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që janë vlerësuar financiarisht e publikuar nga ATP është 17 318 vendime. ATP, nga hyrja në fuqi e Ligjit nr.133/2015 e deri më tani ka përfunduar vlerësimin financiar për 67% të të gjithë

vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Me ecurinë e punës së deritanishme, kjo falë edhe sistemit "Web-Gis" të implementuar nga ATP, ky proces parashikohet të përmbyllet përpara afatit të përcaktuar në ligj për përfundimin e vlerësimit financiar të të gjitha vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit.

EMRAT E 1462 PRONARËVE QË KOMPENSOHEN

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbimri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
Tiranë	REXHEP SHKALLA			
Tiranë	SELIM PICALLI			
Tiranë	QERIM LAMI			356,131
Tiranë				6,077,392
Tiranë	MUHARREM ISUFI			6,149,086
Tiranë	VAJE DOKU			2,452,181
Tiranë	MALIQ DEMNERI			1,901,800
Tiranë	ISLAM QERSHORI			2,297,508
Tiranë	MATJA			339,471
Tiranë	SHYQYRI MILLA			
Lezhë	Mark Preng Zefi			
Tiranë				114,108
Tiranë	SADI HYSEN REXHA			546,863
Tiranë	REXHEP MUSA KARAJ			
Tiranë	REXHEP BASTARI			597,469
Tiranë	NEXHAT KARAPICI			1,481,883
Tiranë	HAXHI SINANI			955,940
Tiranë	ADEM BURNACA			0
Tiranë	RAMAZAN HIMA			2,396,268
Tiranë	GJATA			832,756
Tiranë	SHQIPONJA VATHI			707,470
Lezhë	Zef Gjon Mloti			
Tiranë	ALI E LILA TIRANA			8,066,175
Tiranë	SOTIRA PLLUSKA			
Fier	Bajram Shehu			
Fier	Viktor Ikonomi			
Fier	Jakov Milaj			
Gjirokastrë	Koco Miko			222,486
Korçë	Skender Spaho			3,704,400
Korçë	MUHAMET SHAHOLL			236,791
Korçë	Gazi Lindraku			653,900

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbimri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
Dibër	ISLAM MERTINI			
Tiranë	AQIF MUÇA			1,712,571
Tiranë	SINAN MARA			3,584,000
Tiranë	SHPETIM RAMAZAN F			-9,940,480
Tiranë	LULZIM TAKU			
Durrës	Xhemal Teta			
Korçë	Haki Muka			196,577
Durrës	Ymer Reçi			2,446,605
Lezhë	Gjergj Mark Ndoji			
Korçë	Emine Muka			198,325
Korçë	NASTASI PAPADHAM			272,802
Korçë	Spiro Shopi			1,823,653
Korçë	Eqrem Gegolli			1,654,070
Fier	Reshat Zeqaj			
Fier	Edmond Janushi			7,473,412
Fier	Ahmet Çobra			7,470,222
Fier	Thoma Bakalli			1,289,300
Fier	Kujtim Morina			
Fier	Kamber Metushi			
Korçë	Abasali Jazhxi			1,033,246
Korçë	Fani Vangel			
Korçë	Sulejman Rusi			470,465
Tiranë	GENC HOTI			18,282,537
Tiranë	FATMIRA POJANI			37,502,640
Tiranë	KADRI ETJ ALLA			
Tiranë	FRANC PALI			64,022,364
Dibër	ISLAM QAZIM TASHA			
Dibër	NEZIR SEIT LLESHI			

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbimri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
Dibër	FEHMI JELLA			
Dibër	HYSEN MUHARREM JELLA			
Dibër	NURÇE QAMIL TOSKA			
Korçë	Sabri Spaho			
Korçë	Sabri Spaho			57,792
Lezhë	Ndue Geg Nikolli			188,186
Lezhë	Gjon Preng Marku			82,196
Gjirokastrë	Urani Haje			
Elbasan	MAHMUT DEHIMA			-31,548,700
Korçë				38,880
Tiranë	HAMDI MURTHI			7,814,178
Tiranë	HAMDI MURTHI			8,271,765
Korçë				975,896
Korçë	Selajdin Meka			1,684,287
Korçë	Aishe Peroma			156,435
Kukës	Ramadan Geca			951,529
Korçë				469,306
Fier	Trashgimtare			495,378
Fier	Neim Murataj			7,830,977
Fier	Ali Cakaj			
Fier	Qemal Zotaj			1,514,139
Lezhë	Preng Dede Doci			
Tiranë	MUHARREM STERMASI			
Tiranë	RAMAZAN BALLA			
Tiranë	ÇEKERRI			
Tiranë	MUCA IDRIZ			1,082,301
Tiranë	XHAVIT KRUIJA			
Tiranë	RAMAZAN BEQIRI			
Tiranë	Kadri Pazari			

Berat	Baki Qama	
Shkodër	Cake Mehaj	
Fier	Ismail Gjata	
Fier	Kujtim Sinani	
Fier	Hasan Balla	5,241,730
Fier	Fitim Feleqi	58,415,272
Fier	Qanie Beqiri	3,955,085
Fier	Safet Henzzi	431,791
Fier	Behije Shehu	1,422,538
Fier	Vasil Dhima	4,482,722
Fier	Ilni Myftari	326,867
Fier	Hajdar Strumi	6,544,976
Fier	Monki Dhana	7,801,099
Tiranë	QEMAL DAJA	1,048,267
Tiranë	IBRAHIM PUPA	1,876,099
Tiranë	BAJRAM HOXHA	
Fier	Nasi Dhima	7,826,897
Fier	Koli Goxhomani	774,158
Fier	Jorgji Prifti	
Dibër	ISLAM HOXHA	
Dibër	RIZA HAZIS LETI	34,369
Dibër	MERSIN SULEJMAN MJESHTRI	
Dibër	OSMAN SELMAN BALLA	
Dibër	MERIBAN XHEKA	
Kukës	Mehmet Rame Kapica	313,104
Kukës	Ismail Avdi Guri	191,823
Kukës	Zenepe Sadik Perzhita	1,776,021
Kukës	Qemal Mahmut Beqiraj	276,800
Kukës	Xhevdet Selman Murati	
Kukës	Sali Sule Basha	1,347,065
Kukës	Zyber Mustaf Vata	842,169
Kukës	Selman Ali Vata	841,467
Shkodër	Prend Ndue Lufi	822,010
Shkodër	Nikoll Zef Gjoni	
Durrës	Mark Shota	4,186,185
Durrës	Rustem Syziu	
Durrës	Sabri Llubani	
Durrës	Andrea Rexha, Llasbi Rexha	
Durrës	Eqerem Faja	
Durrës	Ilijana Prusha	
Lezhë	Gjon Preng Deda(Gjoka)	1,228,330
Lezhë	Gjin Ndue Ndoji	744,652
Tiranë	AGIM KOKONOZI	
Korçë	Adil Mullaj	620,117
Dibër	Kisha Ulez	
Lezhë	Zoje Shkëmbi	
Lezhë	Ndue Gjet Gjonaj	
Gjirokastër	Kule Bitri	
Tiranë	IDRIZ ALLMETA	1,200,640
Dibër	Kasem Kasmi	
Dibër	Mark Gjergj Lala	2,290,742
Fier	Mirjana Babamusta	9,118,329
Fier	Llazar Sako	6,048,751
Fier	Izet Ruka	7,593,166
Fier	Hekuran Kumanaku	4,933,123
Fier	Petraq Dimi	1,605,660
Fier	Sadedin Ago	
Fier	Haki Luarasi	
Fier	Haki Luarasi	652,968
Fier	Sefer Alushllari	
Fier	Hasan Llagju	
Fier	Konica Bukuroshi	1,305,937
Fier	Haki Zavalani	13,560,174
Fier	Elisabeta Poda	
Fier	Bido Nuhaj	3,630,464
Korçë	Njazi Bleta	510,510
Korçë		836,125
Lezhë	Hajredin Qyshka	-2,956,500
Korçë	ILO POPULLO	1,109,626
Korçë	HAXHI BAROLLI	740,121
Korçë	Riza Pasho	
Korçë	Bektash Laho	2,871,557
Korçë	Avni Male	399,981
Kukës	Sadik Shuti	
Gjirokastër	Alem Muharrem Shehu	2,266,274
Korçë	Ibrahim Cane	593,330
Korçë	Refije Backa	70,139
Korçë		97,957
Shkodër	Maruka Gjoni	2,400,462
Shkodër	Angelina Lekovia	
Shkodër	Riza Haxhija	1,497,049
Korçë		34,400
Korçë		100,073
Kukës	Hanife Shaqir Murati	1,385,575
Fier	Tomor Hoxha	
Fier	Kostandin Sharra	2,149,291
Fier	Syrja Rrapaj	8,628,622
Fier	Islam Majaci	932,812
Fier	Petraq Xoxa	
Fier	Hajdar Breshnica	4,078,256
Fier	Banush Kumanaku	3,329,068
Fier	Hetem Goga	
Fier	Perikli Ongari	6,233,631
Fier	Sokrat Samarxhiu	1,659,182
Fier	Nexhmie Henzi	1,041,150
Fier	Kostandin Dhima	
Fier	Novruz Mullaj	4,268,380
Fier	Vasillaq Prifti	40,142
Fier	Alqi Kusta	
Korçë	Petrika Çili	232,247
Korçë	Shega Xhafka	179,777
Korçë		1,568,959
Korçë	Harvid Dervishi	1,245,017
Korçë	Muhamet Zhilla	
Korçë	Ali Petriti	
Korçë	Behar Bregu	-379,000
Korçë	Mitat Çika	-9,827,700
Korçë	Stavri Prenda	
Lezhë	Llesh Gjet Nikolli	
Korçë	Nurihan Mece	183,697
Korçë	Olgë Bode	588,360
Korçë	Naum Palla	693,301
Korçë	Burbuqe Konomi	291,976
Korçë	Viktor Cami	98,060
Korçë	Dituri Lenja	662,167
Korçë	Guralje Hoxha	1,683,229
Korçë	Pranvera Baruti	2,434,639
Korçë	Lumturi Lipo	1,029,731
Korçë	Njazi Petriti	429,514
Korçë	Thanas Moni	883,113
Korçë	Shkende Xhaçi	2,100,180
Shkodër	Andrea Martini	51,611
Shkodër	Sanije Druni	653,733
Shkodër	Muhamet Lohi	1,083,821
Gjirokastër	Hysen Seiti	59,257
Gjirokastër	Rrapo Lumani	302,208
Gjirokastër	Brahim Jashari, Sali Jashari	248,877
Fier	Shyqyri Rustemi	7,048,465
Dibër	ASTRIT RIFAT MUHA	
Dibër	RAMAZAN HASAN META	
Dibër	MIFTAR XHEM MARTINI	
Tiranë	MEHMET BYLYKBASHI	7,366,590
Fier	Seit Seitaj	5,162,724
Fier	Thoma Duda	6,544,976
Fier	Beshir Bushi	6,254,734
Fier	Urani Toska	7,664,920
Fier	Qamil Sukaj	704,483
Fier	Selam Fejzaj	3,241,904
Korçë	Mjallaq Gjylameti	2,040,673
Korçë	Kusto Tytymçe	
Korçë	NIGJARE QAMKA	690,750
Korçë	Gjok Percini	243,793
Korçë		46,528
Korçë	Dhimitri Ilo	0
Korçë		0
Korçë		55,783
Korçë		87,640
Shkodër	Xhabir Lukaj	980,600
Korçë	Vangjel Gjergo	451,972
Tiranë	BESNIK PETRELA	1,120,000
Tiranë	REXHEP KETA	3,214,512
Tiranë	REXHEP KETA	4,553,892
Durrës	Haki Hima	6,129,600
Durrës	Haki Hima	
Dibër	NAZMI HYSEN ALIMANI	
Dibër	MEHMET SINANI	
Dibër	MEXHUT JELLA	
Dibër	HAMDİ META	
Elbasan	SHERIF AJAZI	1,385,361
Korçë		542,630
Tiranë	ALI QORDJA	
Tiranë	PETRIT RADOVICKA	54,043,983
Tiranë	MUHAMET E FERIDE PELINGU	
Fier	Kozma Toska	
Fier	Dano Kripa	1,701,583
Fier	Ramadan Mucaj	

(vijan)



Tjetërsimi i tokave në Karaburun, gjykata dënon me 43 vite burg të akuzuarit

VLORE - Gjykata e Shkallës së Parë e Vlorës ka dhënë 43 vite burg për të akuzuarit si të përfshirë në skandalin e tjetërsimit të një trualli prej 220 ha tokë në Karaburun. Për Rajmond Mezin, i cili është edhe përfituesi i tokës, gjykata dha 18 vjet burg nga 21 vite që

kërkoj prokuroria. Për avokatit e Rajmond Mezit, Enkes Hysendhima gjykata dha pafajësinë ndërsa prokuroria kishte kërkuar dënimin me 24 vjet burg. Për Lefter Gjergjin, gjykata dha dënimin me 16 vite burg ndërsa prokuroria kishte kërkuar 19 vite. Për Blerina Dhramin,

gjykata dha 6 vjet burg për akuzën e falsifikimit dhe shkeljen e të drejtës së funksionit publik. Prokuroria kërkoj dënimin me 11 vite burg për akuzën e shpërdorimit të detyrës dhe falsifikim të dokumenteve. Për arshivistin Donika Besimaj gjykata dha dënimin me 3

vite burg për akuzën e shpërdorimit të detyrës, prokuroria kërkoj dënimin me 6 vjet. Sipas prokurorisë, prona ishte regjistruar në emër të Rajmond Mezit në pasuri të ndarë në dy pasuri të tjera, me sipërfaqe prej 130 ha dhe 90 ha. Vendimi u dha nga trupi gjyqësor i përbërë nga Alber Spiro, Albana Selmanaj dhe Laurent Fucia. Prokurori ishte Alber Kulçiq.

Policia e prokuroria: Po verifikojmë tabulatet telefonike të Muçës e 20-vjeçarit

Ervis Kuci

FIER

Ndonëse kanë kaluar pesë ditë nga ngjarja e rëndë e ndodhur në lagjen "29 Nëntori" të qytetit të Fierit, policia dhe prokuroria e këtij rrethi ende nuk kanë mundur të identifikojnë tre prej personave që tentuan të grabisin me armë banesën e Minella Muçit. Fakti se 20-vjeçarit Xhuljan Sollaku nga Elbasani, që mbeti i vrarë gjatë shkëmbimit të zjarrit me policinë dhe Arben Muçën që u plagos në këmbë nuk u janë gjetur me vete telefonat celularë, ka bërë që tre autorët e tjerë të mund t'u shpëtojnë prangave. Të paktën deri tani.

Mësohet se gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe kontrollit të ushtruar në trupin e viktimës e të plagosurit nuk është gjetur asnjë aparat celular. Për këtë arsye, deri tani ka qenë e pamundur që të verifikohet se me kë kanë komunikuar natën e ngjarjes. Xhuljan Sollaku dhe Arben Muça. Por, pavarësisht se nuk u janë gjetur me vete aparatet celularë, burime për "GSH" pohuan se hetuesit janë duke siguruar të dhënat e numrave që janë përdorur së fundmi nga 20-vjeçari dhe i plagosuri prej të afërmeve të këtyre të fundit. Me pas, do t'u kërkohej kompanive celulare përkatëse që të mundësojnë tabulatet telefonike të numrave që janë përdorur nga Sollaku dhe Muça. Gjithashtu, burimet bënë me dije se nuk dihet nëse grabitësit kanë përdorur të njëjtin numër si për të komunikuar me familjarët, ashtu edhe me njëritjetrin. Dyshohet se para se të shkonin për të kryer grabitjen, t'i kenë lënë celularët në automjetin tip "Fuoristradë", me të cilën u larguan tre prej tyre. Ndërkohë, mësohet se janë gjetur vetëm armët e zjarrit e përdorura prej dy grabitësve dhe çanta me veglat që hajdutët kanë përdorur për të hapur bravrën e derës së banesës së familjes Muçi.

DINAMIKA E NGJARJES

Burime pranë grupit hetimor pohuan se të pesë grabitësit kanë qenë duke

Tentativa e grabitjes, Xhuljan Sollaku mbuloi shokët duke qëlluar mbi policinë

Zbardhet dinamika e ngjarjes, ja si u larguan nga banesa e familjes Muçi 3 prej 5 agresorëve



I arrestuari Arben Muça



20-vjeçari i vrarë, Xhuljan Sollaku

hapur derën e çiftit Minella Muçi, madje kanë tentuar të hapin edhe derën e një fqinji. Në momentin kur policia ka mbërritur në vendin e ngjarjes, pranë hyrjes së palatit ku jeton çifti i të moshuarve Muçi, të pesë grabitësit kanë zbritur me vrap shkallët dhe kanë shtënë me armë zjarri ndaj policisë. Arben Muça ka zbritur në trotuar dhe ka qëlluar me kallashnikov drejt policisë, duke mundësuar largimin e tre prej pesë grabitësve. Kur 35-vjeçari është plagosur dhe ka rënë në tokë, ka qenë Xhuljan Sollaku që ka mbuluar shokët e tij duke qëlluar kundër policisë. Por, gjatë shkëmbimit të zjarrit me policinë, Sollaku ka mbetur i vdekur në vend. Duke përfituar nga mbulimi i dy shokëve të tyre, tre grabitësit e tjerë kanë mundur të largohen me një automjet tip "Fuoristradë", ndërkohë që fatmirësisht në radhët e policisë nuk ka pasur të lënduar. Burimet e mësipërme thanë se pavarësisht se ka persona që dyshohet që kanë dijeni mbi ngjarjen, ende nuk janë arritur të sigurohen prova konkrete për të dyshuar të tjerë si të implikuar. Dyshohet se të pak-

tën një prej grabitësve ka qenë nga qyteti i Fierit. Nga hetimet paraprake dyshohet se autorët e tentativës së vjedhjes me armë të mëngjesit së të premtës në Fier kanë pasur informacione se në banesën e Minella Muçit mund të kishte një sasi të konsiderueshme

parash (rreth 1 milion euro). Ndërkohë, nga rindërtimi i dinamikës së ngjarjes dhe këqyrjes së provave të sekuestruara në vendngjarje janë ngritur dyshimet se autorët kanë qenë hajdutë profesionistë. Në vendngjarje hajdutët kanë braktisur një çantë me veglat që kanë

përdorur për të hapur një prej bravrave të derës së banesës së Minella Muçit. Në këtë çantë janë gjetur një celës papagall, një kaçavidë, pinca, një levë e mjete të tjera që përdorshin prej grabitësve. Nga hetimet paraprake dyshohet se grupi në fjalë kishte kohë që vepronin në disa qytete të vendit. Policia dhe prokuroria janë duke verifikuar të kaluarën e Sollakut dhe Muçës për të siguruar informacione dhe prova ndaj bashkëpunëtorëve të tyre të mundshëm në këtë ngjarje. Vetë i plagosuri Arben Muça nuk ka pranuar të bashkëpunojë, duke pohuar para hetuesve se ishte i tronditur e nuk mbante mend gjë. Një ditë më parë gjykata vendosi masën e sigurisë "arrest në burg" pa afat ndaj tij.

Tentuan të kalojnë 23 klandestinë sirianë në Mal të Zi, arrestohen 5 persona nga Tirana

SHKODËR - Policia e Shkodrës ka arrestuar pesë persona nga Tirana, të cilët u transportonin me mjetet e tyre 23 sirianë drejt Malit të Zi. Specialistët e seksionit të trafiqeve të paligjshme, pas një pune të mirorganizuar kanë bërë arrestimin e shtetasve Rolando Shtufi, 44 vjeç, banues në Tiranë, pasi me mjetin e tij me targë AC844T po transportonte 5 shtetas sirianë; Haxhi Murati, 57 vjeç, banues në Tiranë, i cili me mjetin e tij me targë AC855T po transportonte 5 shtetas sirianë; Atli Truplja, 51 vjeç, banues në Tiranë, i cili me mjetin e tij me targë AC856T po transportonte 5 shtetas sirianë; Leonard



Dema, 49 vjeç, banues në Tiranë, pasi me mjetin e tij me targë AC599T, po transportonte 4 shtetas sirianë dhe Kastriot Selamaj, 55 vjeç, banues në Tiranë, pasi me mjetin e tij me targë AB150T, po transportonte 4 shtetas sirianë. Sipas policisë, personat e mësipërm u kapën në afërsi të Urës së Baçallëkut, pasi në bashkëpunim dhe të organizuar me njëritjetrin dhe me mjetet e tyre, të cilët janë të një firme

që ofron shërbim "Taxi" në Tiranë po transportonin 23 sirianë, të cilët kishin destinacion final Austrinë. Pesë të arrestuarit akuzohen për veprën penale "Dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit" e kryer në bashkëpunim. Materiallet në ngarkim të këtyre shtetasve i kanë kaluar prokurorisë së rrethit gjyqësor Shkodër. Burimet e mësipërme sqaruan se 5 shtetasit e arrestuar kanë bërë transportimin e shtetasve sirianë nga Tirana drejt pikës kufitare të Hanit të Hotit kundrejt pagesës prej afro 300 euro për person. Në këtë mënyrë, nga 23 shtetasit sirianë, të arrestuarit do përfitonin një shumë prej afro 7 mijë euro.



Adriatik Llalla, nën hetim për pastrim parash, prokuroria "zbarkon" në KPK

DURRËS - Prokuroria e Durrësit po zhvillon në sekret të plotë hetimin ndaj ish-Prokurorit të Përgjithshëm, Adriatik Llalla. Ndonëse është regjistruar zyrtarisht, nuk ka asnjë të dhënë se çfarë ka rezultuar deri më tani nga hetimi. Megjithatë, burime të besuara për "News 24" dhe "GSH" pohuan se prokuroria 10 ditë më parë i është drejtuar me shkresë zyrtare Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, një prej organeve kryesore të vetingut, duke kërkuar t'i vihet në dispozicion dosja e subjektit të rivlerësimit Adriatik Llalla. Të njëjtat burime konfirmojnë se dosja i është kërkuar trupës që kishte nën hetim administrativ ish-prokurorin e Përgjithshëm, e cila u detyrua të ndërprejë procesin e vetingut, pasi Llalla hoqi dorë nga e drejta për t'u emëruar gjykatës në Apel, duke dalë përfundimisht nga radhët e sistemit të drejtësisë. Burimet saktësojnë se materiali voluminoz iu vu në dispozicion prokurorisë, në kuadër të hetimit penal që po zhvillohet. Në dosjen e KPK ndodhen të gjitha deklaratat e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, si dhe të dhëna të tjera që priten t'i shërbejnë hetimit të çelur. Burimet janë tejet të rezervuara për të dhënë detaje mbi mënyrën sesi Adriatik Llalla ka shkelur ligjin dhe ka konsumuar veprën penale të pastrimit të parave, apo ndonjë veprë tjetër penale. Për momentin, ajo që dihet është se prokuroria ka në duar dokumentet e sekuestruara në disa institucione, si KPK, ILDK-PI, Drejtoria e Pastrimit të Parave, zyrrat noteriale dhe bankat e nivelit të dytë.

VIP

Suplement
Pages

Enë mërkurë 28 Mars 2018

GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Edhe Presidenca me kullë, jepet leja për ndërtesën 9-katëshe
- Ironia e deputetit të PD: Ministrja që luan 'hapa-dollapa'
- Deputetet e PDIU-së, së bashku në një shëtitje pranë parlamentit
- Gratë e LSI-së, në rresht pas Monika Kryemadhit

Miq apo rivalë? Ermal Mamaqi kërkon ndihmë për të 'shpëtuar' nga Luana!



Provokon keqas Kejvina Kthella, del vetëm me robdeshambër



Rrëfëhet zëdhënësja e PD-së: Ja si është të punosh me Bashën



Me të tjera bindje politike?
Flet Ina Zhupa: Do ktheja në demokrat edhe të fejuarin

"Prindërit e mi kanë pasur frikë për jetën time"

Rrëfëhet zëdhënësja e PD-së: Ja si është të punosh me Bashën

Me të tjera bindje politike? Flet **Ina Zhupa**: Do ktheja në demokrat edhe të fejuarin

"Prindërit e mi kanë pasur frikë për jetën time"



Pamela Aliaj

Ekemi dëgjuar shpesh të jetë në vijë të parë për t'i dhënë zë partisë që ajo përfaqëson, shpesh dhe me tone të ashpra për të mbrojtur bindjet e saj. Ina Zhupa vjen ndryshe në "Vip Pages". Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", zëdhënësja e PD-së si dhe pedagogia e shkencave politike në UET, na tregon për jetën e saj edhe jashtë korvizave politike. Si është të jesh një femër në opozitë që i jep zë partisë që përfaqëson? Ina na ka folur edhe për planet afatgjata që ka në jetën e saj si dhe për marrëdhënien e veçantë që ka me të fejuarin e saj Fabian. Planet për martesë? Për më tepër në intervistën e mëposhtme.

Jeni një nga politikanet më aktive të PD-së. Si lindi dëshira për të qenë pjesë e kësaj partie?

Unë kam studiuar shkencat politike dhe lidhja me politikën ka qenë përherë në dëshirat edhe aspiratat e mia. Pastaj angazhimi aktiv erdhi pas angazhimeve të mia publike si pedagogje me ide të djathta që shkruaja në shtyp dhe dilja në media. Gjithçka shumë natyrisht si rezultat i bindjeve të mia personale.

A ka qenë dikush që ju nxit të ishit pjesë e politikës? Mund të them se më mbështeti më shumë sesa nxiti, sepse vendimi ka qenë i imi. Më pas kam marrë mbështetjen dhe motivimin për të vazhduar nga i fejuari Fabian, prindërit e mi Kadri dhe Lili dhe vëllai im Ivi. Roli i tyre është shumë i rëndësishëm në jetën time, por sidomos kur zgjedh të bëhesh pjesë e politikës, edhe më e rëndësishme bëhet. Sepse do jesh në syrin e publikut, të medias, do kesh debate, kundërshti, mund të hasësh edhe shpifje dhe dashakeqësi që pa mbështetjen e njerëzve të zemrës e ke të pamundur t'ia dalësh.



Pse pikërisht zgjodhët PD dhe jo një parti tjetër?

Fillimisht lidhet me idetë e djathta që besoj se janë idetë që i duhen zhvillimit ekonomik, social dhe politik të vendit. Partia Demokratike është partia e vlerave të lirisë, të demokracisë, së ekonomisë së tregut që janë edhe parimet e mia politike. Në mënyrë aktive brenda strukturave të PD u

angazhova në vitin 2013, me daljen në opozitë të PD. Më pas u thirra si koordinatore kombëtare për çështjet e integritetit nga kryetari Basha dhe në janar 2016 u bëra edhe zëdhënësja e partisë. PD sot është partia e vetme që mund t'i kthejë shpresën shqiptarëve për të ndërtuar jetën e tyre këtu. Ka vizion, ka program, ka leadership, ka struktura dhe ka vlera që i

duhen vendit.

Në jetën tuaj është dikush me të cilin dhe jeni fejuar. A keni plane për martesë? Hahaha, në fakt, po, jam e fejuar dhe shumë e dashuruar. Ne bashkëjetojmë dhe më shumë se martesë për ne ka rëndësi dashuria që kemi për njeri-tjetrin. Jemi të lumtur dhe kjo na mjafton. **Partneri juaj është me të njëjtën parti që jeni dhe ju? Nëse do të ndiqte një parti tjetër do të pranoni të ishte me ju?**

Fabi natyrisht që më mbështet mua dhe duke qenë me mua, përkrah edhe partinë time. Por aktivisht nuk merret me politike dhe s'ka lidhje me qarqet politike. Përkatësia partiake nuk ka lidhje me dashurinë, kanë ikur kohërat që mos të dashurohesh me armiq të partisë, (qesh). Për mua nuk do kishte rëndësi dhe po të kishte pasur bindje të tjera politike, edhe pse jam e bindur që do e bëja demokrat gjithsesi.

Si është të jesh dhe zëdhënësja e partisë dhe pedagogje?

Janë të dyja angazhime shumë të rëndësishme dhe



të jesh pjesë e edukimit të tyre profesional për të qenë nesër qytetarë dhe profesionistë të mirë. Zëdhënësja është detyra ime funksion-

klasat që ju jepni lidhur me partinë që përfaqësoni?

Debate në klasë ka gjithmonë, sepse është një nga metodat e mia të mësimdhënies, që i shtyj studentët drejt mendimit kritik. Por nuk janë në lidhje me partinë që unë përfaqësoj, por për temat që kemi në leksione. Duke qenë se unë jam tek shkencat politike kemi edhe tematike që lidhen me elitat politike, me partitë politike, me sistemet qeverisëse etj., dhe mund të dalim edhe në aktualitetin shqiptar, por unë aty jam pedagogje dhe jo zëdhënës.

Si keni reaguar nëse ndonjë nga studentët ka folur keq për PD-në?

Duke u nisur nga studentët e shumtë që iu jap edhe iu kam dhënë mësim, është normale që të kem pasur me PS, PD, LSI, por kjo nuk ndikon fare në marrëdhëniet e mia me ta. Kam pasur dhe kam studentë shumë të mirë që janë me PS, për shembull, dhe mbasi mbarojnë, ruajnë respekt për mua si unë për ta.

A e keni menduar veten



me peshë. Pedagogje është profesioni im që e kam dashur gjithmonë që e vogël, edhe e dua, e bëj më shumë pasion dhe përkushtim. Mendoj se s'ka gjë më të rëndësishme se të kontribuosh tek rinia e vendit tënd,

ale në partinë më të madhe opozitare, një përgjegjësi e madhe dhe një vlerësim i madh që kryetari Basha ma ka besuar mua. Ndjehem e privilegjuar që jam zëri zyrtar i demokratëve shqiptarë. A nxiten shpesh debate në



menduar. Të largohem nga vendi s'e kam menduar as kur isha pak më e re, gjimnaziste apo studente, jo më tani. Nga politika nuk largohem, sepse mendoj se mund të jap një kontribut për vendin tim, të bëj gjënë që besoj se është e duhura për shqiptarët. Taksat, faturat, këto rrugë, këtë shëndetësi i përjetojnë edhe prindërit e mi, edhe njerëzit e mi si gjithë shqiptarët.

Si e mendon veten Ina pas 5 vitesh?

Planet kaq afatgjata me siguri do kenë edhe gjëra që nuk dalin. Përtej shakasë, disa gjëra mund t'i them, e mendoj veten me titullin Prof.Asoc.Dr të fituar, unë tashmë jam Doktoore e Shkencave. E mendoj me kontribut në fushën akademike, po ashtu me rëndësi në fushën politike dhe mbi të gjitha një njeri i respektuar në shoqëri.

Si e priti familja juaj faktin që u bëtë pjesë e PD-së?

Ishin të lumtur që po bëja gjënë që doja. Ata kanë qenë përherë në krahun tim, në zgjedhjet që kam bërë. Prindërit patjetër që kishin atë merakun, se duke qenë vija e parë mund të rrezikojta në kuptimin e kërcënimeve. Se politika shqiptare po luftonte me kriminelet në parlament, ishte koha që kërkohej ligji i dekriminalizimit p.sh. Mund të kujtoj kur unë kam dalë në deklaratë të forta kundra Sajmir Tahirit kur ai ishte ende i plotfuqishmi i ministrisë së Brendshme, prindërit kishin një farë frike për mua. Megjithatë mbi frikën ka dominuar përherë krenaria që kanë për mua dhe lumturia që më shohin mirë.

Si është të punosh me Lulzim Bashën? A kenë pasur mosmarrëveshje më parë?

Të punosh me Lulzim Bashën është fat dhe përgjegjësi. Është një njeri super i formuar, me një kulturë perëndimore, që të ofron shumë lehtësi në komunikim, nuk ka barriera. Jo vetëm për ne që jemi stafi i tij, por edhe çdo qytetar që e takon ngelet i impresionuar nga Basha për nga mënyra si e trajton dhe si e dëgjon. Zakonisht liderët vetëm flasin dhe nuk dëgjojnë, ndërsa Basha ka aftësinë edhe të dëgjojë qytetarët dhe këdo përveç se të flasë me elokuencë.

Nuk kemi pasur asnjëherë mosmarrëveshje, edhe për faktin se çdo gjë bisedohet dhe sqarohet dhe të gjithë jemi bindur që është vendimi më i mirë që po marrim. Basha është lider i formatit europian që i duhet vendit për një qeverisje më të mirë dhe më demokratike.

deputete të PD-së apo diçka më shumë? A e keni në planet tuaja afatgjata?

Planet e mia në PD janë të jap kontribut të pandaluar për të bërë një opozitë të fuqishme dhe për të rrezuar sa më shpejt Ramën nga pushteti për të mirën e çdo shqiptari të ndershëm. Pastaj postet politike do jenë të mirëpritura kur të vijmë si propozime të demokratëve si

rrjedhojë e punës time dhe kontributit në parti. Tani është e rëndësishme të bashkojnë forcat të gjithë, sepse kemi një të keqe të madhe përballë, dhe ambiciet personale t'i analizojmë në këtë drejtim.

A ka pasur ndonjë moment që keni dashur të hiqni dorë nga politika e të largoheni jashtë vendit?

Jo, asnjëherë nuk e kam



Edhe pse i shohim shpesh që janë rivalë në marrëdhënien e tyre mediatike, ata në të vërtetë janë miq në jetën e përditshme. Ermal Mamaqi dhe moderatorja seksi e "Shiko kush luan", Luana Vjollca, shpesh janë parë të thumbohen publikisht për shkak të programeve të tyre që transmetoheshin çdo të shtunë në të njëjten orë. Por mes tyre, nga videot e befasishme duket qartë se nuk ka asnjë hatërbetje. Luana është parë krahas Ermalit duke drekuar dhe nuk kanë munguar të qeshurat pa fund. Por me siguri duhet të kenë ndonjë projekt në mendje që e kanë publikuar edhe në "Instagram" videon. Mbase do ta shohim bukuroshen seksi të ftuar në emisionin 'Xing' me Eramal Mamaqin? Ende nuk dihet. Presim deri të shtunën.

Miq apo rivalë? Ermal Mamaqi kërkon ndihmë për të "shpëtuar" nga Luana!



Nuk është hera e parë që velina e 'Xing me Ermalin' provokon në rrjetet sociale. Këtë herë ajo ka postuar në faqen e saj në "Instagram" një foto ku shfaqet e veshur me robdishambër dhe pamja e saj duket mjaft tërheqëse. Bukuroshja seksi shfaqet gjithmonë sensuale duke provokuar herë pas here ndjekësit e saj me fotot që ndonjëherë nuk i lënë vend fantazisë. Edhe kësaj radhe nuk ka mbetur pas me robdeshambërin që duket sikur do t'i bie nga trupi.

Provokon keqas Kejvina Kthella, del vetëm me robdeshambër

BULEVARDI

Na merrni seriozisht!

POLITIK



Edhe Presidenca me kullë, jepet leja për ndërtesën 9-katëshe

Edhe Presidenca bëhet me kullë. Mësohet se ngjitur me godinën e Presidencës ku ndodhet parkingu privat do të ndërtohet një pallat 9-katësh, duke shfrytëzuar një sipërfaqe prone 1788 metër katrorë. Kompania ndërtuese është Invest Society shpk. Por ky projekt ka shqetësuar Garden e Republikës, për shkak se sipas saj cenon sigurinë kombëtare. Kjo nuk është hera e parë kur ngjitur me Presidencën tentohet të ndërtohet kullë. Edhe në vitin 1999 pikërisht në të njëjtin vend bashkia e Tiranës ka dhënë leje ndërtimi për një pallat dhjetë katesh. Por leja u anulua me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit, për të njëjten arsye, atë të cenimit të sigurisë kombëtare. Ketë herë siguria kombëtare duket se ka rënë dhe Presidenca e Republikës do të bëhet me kullë.



Ironia e deputetit të PD: Ministrja që luan 'hapa-dollapa'

Deputeti i PD Luçiano Boçi nuk ka shpresë se sot, ministrja e Kulturës Mirela Kumbaro do të tregojë diçka në lidhje me Teatrin në komisionin e Edukimit. Siç shkruan në një postim në rrjetet sociale, Boçi thotë se "Nuk e di çfarë roli ka marrë përsipër të luajë nesër (sot), por 100% do bëjë teatër. Më mirë të themi do luajë përsëri hapa-dollapa, siç ka bërë deri tani". "Sepse: - Kur Rama deklaronte shembjen e Teatrit, Kumbaro thoshte që thjesht do zhvendosim artistët tek Turbina! - Kur Velliaj deklaroi se ka projekt, Kumbaro solli shkresë në komision, ku theksonte se nuk ka as projekt, as studim fizibiliteti! - Kur ASG e shënon gati 6000 m2 sipërfaqen e Teatrit, Kumbaro deklaroi se Teatri do jetë 3000 m2. - Kur Rama paraqiti PROJEKTIN plagjiaturë, Kumbaro shkruante se ai është koncept e jo projekt",- tha z. Boçi.

Gratë e LSI-së, në rresht pas Monika Kryemadhit

Deputetët e LSI-së janë mbledhur dje, të gjitha në aktivitetin e konstitimit të Aleancës së Grave Deputete. Por si në çdo event nuk kanë mundur të largohen nga njëra-tjetra pa bërë një foto përmbyllëse. E para në rresht kryetarja Monika Kryemadhi dhe pas saj janë vendosur në rresht të gjitha gratë e vajzat deputete të LSI-së. Ato shfaqen mjaft të qeshura dhe të shoqërueshme me njëra-tjetrën. Ndoshta duket edhe nga solidariteti që ka injektuar mes tyre, vetë kryetarja, e vetmja grua në krye të një partie politike.



Deputetet e PDIU-së, së bashku në një shëtitje pranë parlamentit

Elena Xhina dhe Reme Lala janë dy deputetet e reja të Kuvendit, të dyja pjesë e PDIU-së. Siç duket edhe nga fotoja ato janë ndjerë shumë mirë së bashku, duke përfaqësuar çamët. Në një ditë të bukur para seancës së Kuvendit, ato kanë përfituar të ecin disa hapa së bashku, drejt sallës së Kuvendit, duke shpalosur po ashtu edhe hijeshinë e tyre. Deputetja e re, Reme Lala, e cila triumfoi në Dibër ka një pamje që bie në sy në mes të të gjitha grave e vajzave që janë pjesë e kësaj legjislature.



BULEVARDI

Na merrni seriozisht!

POLITIK



ITALI - Policia italiane ka arrestuar 4 persona në kuadër të një operacioni antidrogë në Firence. Në mesin e 4 personave të arrestuar për trafik droge është edhe një shqiptar i identifikuar si P.D. Shqiptari ishte pjesë e një bande, ku bënte pjesë edhe një mafioz italian, i cili ishte dënua me parë me burgim të përjetshëm. Hetimet nisën që në dhjetor të vitit 2016. Qindra përgjime telefonike dhe mjedisore. Mes të arrestuarve të policisë në Firence është edhe shqiptari P.D.. Arrestimi i tij do të kishte kaluar "lehtë", nëse nuk do të ishte pjesë e një grupi kriminal, ku pjesëtarë do të ishin edhe anëtarë të "Cosa Nostra"-s. Kështu, në një operacion të policisë në Firence, veç shqiptarit u arrestuan dy vëllezërit Giovanni e

R. D. hiqej si agjent i Interpolit

Trafik droge me mafiozin e rrezikshëm, kapen 4 persona mes të cilëve edhe shqiptari i 'Cosa Nostra'-s

OPERACIONI

Në një operacion të policisë në Firence, veç shqiptarit u arrestuan dy vëllezërit Giovanni e Renato Sutura si dhe Ruben Crespo Guerra. Më i rrezikshmi është Giovanni Sutura, i cili ka vrarë dy persona. Në vitin 1985 ai ka vrarë edhe 17-vjeçarën Graziella Campagna. Ai ishte liruar me kusht, për sllje të mirë. Por të 4 të arrestuarit kishin ndërtnuar një mekanizëm të "suksesshëm".

Renato Sutura si dhe Ruben Crespo Guerra. Më i rrezikshmi është Giovanni Sutura, i cili ka vrarë dy persona. Në vitin 1985 ai ka vrarë edhe 17-vjeçarën Graziella Campagna. Ai ishte liruar me

kusht, për sllje të mirë. Por të 4 të arrestuarit kishin ndërtnuar një mekanizëm të "suksesshëm". Mbiillnin kanabis në Spanjë dhe më pas e fusnin në territorin italian. Kishin marrë një

lokal në qendër të Firences, që e përdornin për të shpërndarë drogë. Nga hetimet e policisë rezultoi se droga pasi vinte nga Spanja në Itali, përfundonte në duart e shqiptarit P.D., i cili merrej me magazinimin dhe shpërndarjen. Por P.D. nuk është një emër i panjohur për policinë. Në vitin 2015 ai ishte pjesë e një hetimi, për mashtrim. Si pas organit të akuzës, P.D. në bashkëpunim me Irme Musaraj, i kanë marrë nëpërmjet mashtrimit një sasi lekësh mjekut Emil Kalimeri. Këto akuzat nuk u vërtetuan nga Gjykata e Apelit dhe mjeku



nga ana tjetër u shpall fajtor për përndjekjen e Irme Musaraj. Është interesant është fakti se P.D. hiqej si agjent i Interpolit. Po ashtu disa muaj më vonë P.D. do të arrestohej pasi shkaktoi një

aksident. P.D. ka qenë një frekuentues i rregullt i ambienteve me muzikë tallava, ndërsa nuk mungojnë as fotot me këngëtarin e kësaj rryme muzikore, Muharrem Ahmeti.

Trafikonte marijuanë nga Spanja në vende të tjera të Bashkimit Europian

Shkatërrohet grupi kriminal nga Europol, mes 18 të arrestuarve edhe shqiptarë

Operacioni "Carambolas", sekuestrohet 1 ton drogë

Shkatërrohet një tjetër grup kriminal i trafikut të drogës. 18 persona kanë përfunduar në pranga, ndërsa 9 të tjerë janë proceduar penalisht, pas një operacioni ndërkombëtar antidrogë, ku u sekuestrua 1 ton marijuanë. Operacioni i koduar i "Carambolas" u krye nga Europol në bashkëpunim me autoritetet spanjolle dhe ato gjermane. Përveç sasisë prej 1 ton marijuanë, autoritetet sekuestruan gjithashtu 212 mijë euro kesh, armë zjarri, municione dhe 8 automjete. Sipas një njoftimi të publikuar në faqen zyrtare të Europol, ky grup kriminal trafikonte marijuanë nga Spanja në vende të tjera të Bashkimit Europian, në veçanti Gjermani nëpërmjet një rrjeti të vendosur në Malaga dhe Granada të Spanjës, që drejtohehin nga Bremen, Gjermani. "Rrjeti kriminal ishte strukturuar në një formë të tillë, që edhe nëse një celulë e vetme do të zbulohet nga policia, sasia e jash-tëligjshme e drogës do të ishte gjithsesi e garantuar", thotë Europol. Hetimet nisën qershorin e shkuar, pasi një shtetas gjerman, pjesë e kësaj organizate kriminale, u pa duke marrë një sasi të madhe marijuane në jug të Spanjës. Faza e parë e operacionit u fokusua në shkatërrimin e dy fabrikave të mëdha marijuane, të zbuluara në jug të vendit, ku u sekuestruan rreth 100 kilogramë drogë dhe 172 mijë euro. Dy oficerë të policisë spanjolle mbetën të plagosur rëndë gjatë kapjes së një prej anëtarëve të bandës. Anëtarët e kësaj organizate kriminale u arrestuan dhe u morën në pyetje nga policia. Ata janë nga 8 shtete të ndryshme: Shqipëria, Gjermania, Kroacia, Spanja, Armenia, Serbia, Siria dhe Turqia.



HETIMI
Mësohet se hetimi nga strukturat e Europol dhe policitë përkatëse të katër vendeve filloi në qershorin e kaluar, pasi një shtetas gjerman, anëtar i rrjetit kriminal, u zbulua duke blerë një sasi të madhe të marijanës në jug të Spanjës. Faza e parë e operacionit u përqendrua në çmontimin e dy fabrikave të marijanës të zbuluara në jug të vendit, ku u konfiskuan gati 100 kg marijuanë si dhe 172 000 euro para kesh.

PLAGOSJA E 2 OFICERËVE

Dy oficerë të policisë spanjolle mbetën të plagosur rëndë gjatë kapjes së një prej anëtarëve të bandës. Anëtarët e kësaj organizate kriminale u arrestuan dhe u morën në pyetje nga policia. Ata janë nga 8 shtete të ndryshme: Shqipëria, Gjermania, Kroacia, Spanja, Armenia, Serbia, Siria dhe Turqia.

Vdes 13-vjeçarja nga Puka, dyshohet nga truthi, 3 fëmijet e tjerë në spital

Pukë - Një 13 vjeçarja ka ndërruar jetë mëngjesin e ditës së djeshme në fshatin Berishë i Epërm në Fushë Arrëz. Mjekët dyshojnë se kanë qenë komplikacion i fruthtit që ka çuar në vdekjen e saj. Ndërkohë, janë transportuar me helikopter drejt QSUT tre fëmijet e tjerë të familjes, 11, 16 dhe 17 vjeç. Fëmijet po trajtohen në pediatri dhe në spitalin infektiv në QSUT. Si pas mjekëve nuk ka shenja klinike për fruth dhe po kryhen të gjitha analizat për të vërtetuar diagnozën. Ndërkohë Ministria e Shëndetësisë ka ngritur një grup pune për verifikimin e shkakut të vdekjes së 13-vjeçares. Ekspertët e Institutit të Shëndetit Publik pohojnë se deri më tani janë 271 raste të prekura nga fruthi, 64% e tyre i përkasin grupmoshës nën 1 vjeç. Gjatë këtij viti janë konfirmuar të kenë humber jetën edhe shkak të komplikacioneve të shkaktaura nga bronkopneumonia dhe temperatura e lartë që jep fruthi 3 persona, rasti i fundit është ai i ditës së djeshme, dhe dy foshnje 8 dhe 4 muajsh.

Sekuestrohen 160 kg kanabis, përfundojnë në pranga 6 persona nga Lezha e Shkodra

LEZHË - Gjashtë persona janë arrestuar dje nga policia e Lezhës, pasi akuzohen për prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike. Bëhet fjalë për shtetasit Nikolin Marpalaj, 49 vjeç, banues në Lezhë; Kristjan Pepaj, 25 vjeç, banues në Shkodër; Doren Pepaj, 22 vjeç, banues në Malësinë e Madhe; Erjon Ndoci, 29 vjeç, banues në Lezhë; Jolanda L, 29 vjeçe, banuese në Shkodër dhe Mir-

sada P. 25 vjeçe, banuese në Velipojë. Sipas bluve, këta persona u kapën pas informacioneve të marra në rrugë operative se në fshatin Balldren, në banesën e shtetasit Nikolin Marpalaj, ata në bashkëpunim me njëri-tjetrin po përgatiteshin për të transportuar e shitur një sasi lëndë narkotike.

Gjatë kontrollit të ushtruar nga policia në banesën e shtetasit Nikolin Marpalaj janë gjetur dhe sekuestruar dhe në cilësinë e provës materiale 160 kg kanabis, një armë gjahu, dy peshore elektronike, 12 telefona celularë të markave të ndryshme, një automjet tip "Golf 4" në pronësi të shtetasit Kristian Pepaj

dhe një automjet tip "Mercedes Benz" në pronësi të shtetasit Erjon Ndoci. Materialet në ngarkim të këtyre shtetasve do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, për veprat penale të "Prodhim e shitje të lëndëve narkotike", e kryer në bashkëpunim.

INTERVISTA/ DEBATI

Ema Andrea:

Kullat do "i marrin frymën" teatrit, politika të mos na vijë në funeral

Fatmira Nikolli

"Ministritë shkojnë e vijnë, unë mbetem Ema Andrea,
secili të mbajë kryqin e vet mbi shpinë"

Teatri Kombëtar për mua: një dashuri e dhimbshme për të cilën do vazhdoj të jetoj e të punoj sa të mundem, pa kërkuar lapidarë sakrificash apo viktimash. Uroj të jem gjallë e të dëgjoj një 'më fal' nga politika për artistët. Nëse nuk do e dëgjoj, uroj të mos kenë kurajë të vijnë në funeralin tim, apo të asnjë artisti! Për momentin dëgjojmë 'plasje'. Për sa të mundem, për këtë do punoj e luftoj, qoftë edhe e vetme dhe e paragjyuar". Kjo është deklarata e aktore dhe regjisores Ema Andrea, e angazhuar në protestën e artistëve kundër shpërnguljes së trupës së Teatrit Kombëtar të "Turbina" dhe një prej kandidatëve për postin e drejtuesit të TK-së, post ende vakant zyrtarisht.

Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Andrea thotë se me Ministrinë e Kulturë raportet kanë qenë gjithëherë institucionale dhe se "nëse nuk jam dakord me një vendim që më përket, do t'i bëj gjithmonë nder ministrisë duke u shprehur. Se si do reagojë ministria, është çështje e tyre, jo imja! Kanë për detyrë të më dëgjojnë. Në këtë botë secili duhet të mbajë kryqin e vet, ashtu si mundet!"

Sipas saj, artistët i quajnë yje sa herë u intereson por asnjëherë nuk janë trajtuar si të tillë. Shton mandej se ministritë shkojnë e vijnë sipas politikës, ndërsa ajo mbetet Ema Andrea. Sa i takon projektin të teatrit, Andrea shton se nuk u ftua në takimin e prezantimit, sepse listabërësit e dinin që nuk do të ishte dekor, por se për të, "projekti u afrua prej presionit që bëjnë artistët".

A do të jetë ajo në krye të TK-së si drejtoreshë? Andrea është evazive në përgjigje, por në fund intervista e saj, që ka numëruar një sërë problemesh të teatrit, mbyllet me këto fjalë: "KM deklaroi që është i kënaqur me shitjen e biletave, a thua se Teatri Kombëtar është ndërmarja që i sjell të ardhura buxhetit të shtetit. Si thua ti, ç'do të ndodhë?"

- Ema në shkurt ishit shumë aktive për çështjen e Teatrit Kombëtar. Ishit edhe në përfaqësimin e aktorëve që SASE dërgoi në takim me ministrin. Çfarë ndodhi pas atij takimi?

Unë kam qenë dhe jam aktive për çështjet e teatrit dhe artistit prej vitesh, shpesh me reagime personale e këtë radhë në krah të kolegëve. Unë nuk përfaqësoj SASE, nuk jam



Në foto:
Ema Andrea

anëtare e kësaj sindikate, por ishim së bashku për çështjen e ligjit dhe godinës së teatrit. Pavarësisht tymnajave për të shkaktuar keqkuptime apo 'scoop' pas një fjalë, ne ishim të qartë për çfarë kërkonim. Të ishim të konsideruar si komunitet në vendimet për teatrin. Ky besoj do të ish fillimi i një bashkëbisedimi të barabartë dhe të drejtë. Besoj diçka u mbërrit, pasi shqetësimi për teatrin mori përmasa më të gjera. Politika, edhe pse jo plotësisht, u detyrua të dëgjojë, pavarësisht reagimit të ngadaltë apo ironik ndonjëherë. Në takimin në MK, ne ishim përfaqësues të artisteve të mbledhur në sallën e TK, të cilët kërkonin një axhendë takimesh me përfaqësues të komunitetit mbi ligjin, transparencë për godinën e TK dhe disa kërkesa të artisteve të Cirkut Kombëtar.

Pas atij takimi, axhenda e takimeve, në dijeninë time, nuk është bërë ende, theksoj, në dijeninë time. Ndërsa për sa i përket godinës, ju e

gjere dhe me ekspertë të fushës.

- Si ju është dukur projektin? A jeni dakord me mënyrën si erdhni ai projektin?

Projekti u afrua besoj prej presionit që bëjnë artistët. Pas deklaratash të ndryshme e të pavendosura të ministres, erdhi presioni i artistëve e më pas prezantimi i shpejtë. Kështu si është panorama nuk besoj se ka nevojë për shumë koment, veçse artistët duhet të kishin reaguar më shpesh e më herët për problemet e tyre.

- E kishit parë më herët projektin?

Ashtu si të thashë, më është prezantuar nga kryetari i bashkisë dhe kam të njëjtin mendim.

- Ka shumë aktorë që janë kundër shembjes së TK-së, duan të ruajnë edhe godinën aktuale, për shkak të historisë së saj. Ju në atë godinë keni qenë si aktore e si regjisore. Ç'është ajo godinë për ju?

Në skenën e Teatrit Kombëtar kam hipur shumë e re. Nuk kam pasur lidhje të gjata me atë institucion për arsye mbylljeje, mospranimi dhe organizimi. Ndoshta, prej mendimeve të ndryshme për artin dhe teatrin apo mënyrën, a shijet e drejtorëve. Por, edhe për zgjedhjen time në këtë pikë mospërputhjeje. Çfarë më ka shqetësuar dhe më shqetëson është niveli artistik e kulturor që meriton një institucion i tillë, i cili nuk duhet të katandisej në ndërmarrje prodhimi, por në një qendër që gjeneron mendim të ri, shije e identitet. Dikur, për mua ishte e vetmja sfidë, sepse mendoja që duhej merituar skena ku kishin krijuar Kadri Roshi, Roland Trebicka, Naim Frashëri, Pirro Mani, Yllka Mujo etj. Por, pas shumë pak vitesh, doja të rrija larg, e sot do të doja t'i rrija në krah që të rigjeja fytyrën e dinjitetit të humbur për shumë faktorë e fajtorë.

Një institucion i lënë pas dore nga politikat e gjithë këtyre viteve, injorim që u pranua në heshtje të dhimbshme çdo ditë nga i gjithë komuniteti. E sot nuk di nga t'i nënsh problematikat e thëna e të pathëna të teatrit e komunitetit. Duhet që duhet vullnet për ta ringritur aty ku meriton ky institucion, të cilin pa doganë e quajnë tempull, por nuk e trajtojnë në asnjë moment si të tillë. Artistët i quajnë yje sa herë u intereson, por asnjëherë nuk janë trajtu-



ar si të tillë.

Ja çfarë është Teatri Kombëtar për mua: një dashuri e dhimbshme për të cilën do vazhdoj të jetoj e të punoj sa të mundem, pa kërkuar lapidarë sakrificash apo viktimash. Uroj të jem gjallë, ditën që politika do të përulet para artistit e do heshhtë kur ai të flasë, të kundërshtojë, të provokojë apo të bërtasë për shqetësimet sociale e historike. Uroj që artistët të mos jenë pjesë e kujtesës patetike e keqardhëse, por mendimi ndriçues për shoqërinë e së ardhmes.

Uroj që ata që e krijuan me sakrificë e pasion teatrin shqiptar të mos mberbin një foto e varur në mur, që e përdorin në përkujtimore, por të kthehen në çfarë janë, e çfarë meritojnë. Por, edhe për zgjedhjen time, shembull për shoqërinë, frymëzim për të rinjtë, etalon i respektit dhe vlerës. Artistët janë vepër e tyre, historia e teatrit, jo ndërtesa. Teatri Kombëtar janë vprat dhe artistët! Gjithkush që ngjitet në atë skenë duhet së pari të mendojë për peshën e përgjegjësisë së historisë që mban mbi shpinë e pastaj të numërojë suksesin personal apo shfaqjen e radhës. Uroj të jem gjallë e të dëgjoj një 'më fal' nga politika për artistët. Nëse nuk do e dëgjoj, uroj të mos kenë kurajë të vijnë në funeralin tim apo të asnjë artisti. Për momentin dëgjojmë 'plasje'. Për sa të mundem, për këtë do punoj e luftoj qoftë edhe e vetme dhe e paragjyuar.

- A kanë ndryshuar raportet tuaja me Ministrinë e Kulturës prej ditës kur ju dolët kundra zhvendosjes së TK-së të "Turbina"?

Raportet e mia me MK? Kanë qenë gjithmonë institucionale. Kam thënë mendimin tim pozitiv apo kundërshtitë e mia, qoftë edhe në nivel personal. "Turbina" në vetvetë për mua ishte kënaqësi e madhe. Ka qenë dhe është një godinë ku fillllova të ëndërroj një hapë →

REFORMA



◀ sirë alternative, ku më në fund mund të punohej e krijohej përtej institucioneve shtetërore. Pas një shekulli që e bën bota, më në fund do e kishim edhe ne. Por tani, kjo ndërtesë, statusi i së cilës është ende i padëklaruar dhe askush nuk pyet e askush nuk përgjigjet, do t'i përkasë, prej halit, sërish mainstream-it! Boh! Në këtë ditë u katandisëm dhe nuk kemi çfarë të themi. Nuk e di çfarë mendimi ka Ministria e Kulturës për mua pas kundërshtisë sime, por kjo nuk ndryshon as investimin tim si artiste, as talentin tim, as vlerat e mia edhe pse projektet e mia do varen nga Ministria e Kulturës. Unë kam pozicionin tim në këtë shoqëri dhe nëse nuk jam dakord me një vendim që më përket, do t'i bëj gjithmonë nder ministrisë duke u shprehur. Se si do reagojë ministria, është çështje e tyre, jo imja! Kanë për detyrë të më dëgjojnë. Në këtë botë secili duhet të mbajë kryqin e vet ashtu si mundet! Ministrinë shkojnë e vijnë sipas politikës, unë mbetem Ema Andrea.

Çfarë po ndodh me konkursin për drejtor?

KM deklaroi që është i kënaqur me shitjen e biletave, a thua se Teatri Kombëtar është ndërmarrja që i sjell të ardhura buxhetit të shtetit. Si thua ti, ç'do të ndodhë?

Shkrimtari Rudi Erebarea ka organizuar dje protestë qytetare për teatrin me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Teatrit. Më herët, ai pretendonte se artistët janë kërcënuar të mos dalin në protestë. 27 marsi është Dita Botërore e Teatrit, por e gjeti Teatrin tonë Kombëtar ende pa një zgjidhje për të ardhmen e tij. Artistët vijnë që prej 1 muaji e gjysmë të protestojnë për shembjen e godinës historike.

Skënder Gjinushi dhe Artan Fuga janë përplasur dje për çështjen e reformës së Akademisë së Shkencave.

Gjatë mbledhjes së grupit të punës për hartimin e projektligjit "Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë" dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij", Gjinushi si kryetar i komisionit për reformën me akademikun Fuga, nuk ranë dakord.


Takimi i mbajt pas marrjes së mendimeve dhe pas konsultimit me ekspertët e Akademisë Gjermane "Leopoldina" dhe ALLEA-s dhe mbledhjeve të zgjeruara konsultuese për marrjen e mendimeve me përfaqësuesit e institutëve dhe qendrave të kërkimit shkencor në universitete e më gjerë.

Ndërsa akademikët zhvilluan takimin përfundimtar (përpara dërgimit të drafteve në Këshillin e Ministrave), dje, synim ishte informimi mbi punën e kryer dhe njohjen me draftligjin "Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë" dhe draftit të "Kodit etik në veprimtarinë akademike dhe në kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë".


GJINUSHI

Skënder Gjinushi bëri me dije se projektligji ka sjellë ndryshime në Akademi. Tha se synohet hapje e Akademisë që në anëtarësi, se pse nuk janë më vetëm nga asambleja sugjerimet, por edhe nga institucionet e tjera. "Sa më cilësorë të jenë të zgjedhurit e rinj, aq më të mirë do jenë kontributet. Përcaktohet qartë edhe roli i akademikut, ai zgjidhet për atë që ka bërë në karrierë sepse është ambicie e angazhim personal, e pos kësaj ka një detyrë morale që si anëtar i kësaj trupe honorifike e elitare të kontribuojë në zhvillimin e shkencës në institucionet e vendit, duke këshilluar përmes opinionave ndaj qeverisë", tha Gjinushi duke shtuar se ndaj u jepet rëndësi marrëdhënieve me qeverinë, duke vënë norma për bashkëpunim me institucionet e tjera.

Mes të tjerash, në projektligj merret parasysh edhe penalizimi i akademikëve. "Meqë jemi në kohë vetingu, të gjithë e kanë mendjen të penalizimi. Gabimi ka qenë që nuk është folur edhe për nivelin e kërkimit shkencor, kur janë dhënë tituj e grada doktor në universitete. Nëse ka firo, do kesh profesorë falsë e akademikë po ashtu. Penalitetet shkojnë deri në heqje të titullit e gradës, kur janë marrë pa meritë, me plagjiaturë e pa punime false. Meqë doktoraturat janë themeli e stimul për mesazhin që japin. Veting mbi Akademinë? Mbi të gjithë, kushdo qoftë. Kush e ka doktoraturën në meritë, bëhet akademik në çdo



Në foto: Artan Fuga



Në foto: Skënder Gjinushi

AKADEMIA E SHKENCAVE

Fuga përplasat me Gjinushin për reformën: Veting edhe këtu



Në foto: Takimi i djeshëm në Akademi

Fuga: Druaj se pas zgjedhjeve farsë, do të kemi një reformë farsë

rast. Kush e ka false, false i shkon e gjithë jeta", tha Gjinushi.

Sipas tij, për këdo që ka pretendime, ka kallëzim a denoncim publik për falsitet të veprave a punimit me të cilin ka marrë titullin ajo rishqyrtohet. Ai që e bën shkeljen duhet të pajtohet me heqjen e të kërkojë falje publike. "Kjo kthehet në normë ligjore, ngrihet institucione, mbase pranë Akademisë. Akademia mbetet buxhetore, akademikët nuk paguhen se punësohen. Akademikët kanë titull që shoqërohet me vlerësim monetar.

Atë sherrin akademik me institute a jo e quajtem pa vlerë, se do ketë institute e komisione afatsh-

kurtra", përfundoi Gjinushi.

I pyetur për faktin që Artan Fuga ishte kundër projektligjit, Gjinushi tha se "një kundër duhet edhe për lezet. Populli thotë për të prishur syrin".

ARTAN FUGA

Akademiku që në gjithë këta muaj ka kundërshtuar Akademinë e Shkencave, Artan Fuga, tha ligji i ri ka mendësinë që Akademia të jetë me një model të dështuar, pra si një ombrellë institutesh kërkimore.

"Institutet që kanë dalë nga dera, të hyjnë nga penxherja. Ende mendohet se Akademia e Shkencave të jetë koka e sistemit të

kërkimit shkencor", thotë Fuga, duke shtuar se ligji është i mbushur me formulime kundërtëne. Për të, konsiderimi i Akademisë së të rinjve si pjesë e Akademisë është paradoks logjik.

Duke u treguar i gatshëm të argumentojë qëndrimet e tij, Artan Fuga tha se në parim projektligji është i dështuar dhe nuk të çon askund.

Ai shton se komisioni ad hoc i reformimit të Akademisë është bllokuar me funksionimin e tij, ka punuar larg akademikëve, seksioneve e asamblese, me konflikte interesi, me superpozime me komisionin pranë zyrave të Ministrisë së Arsimit, unë mendoj se ka ardhur koha që ai të konsiderohet i shkrirë. "Unë sot druaj se pas zgjedhjeve farsë, do të kemi një reformë farsë", përfundoi ai.

Opinion / Ditës

Nga Sulejman Mato

(Vijon nga faqja e parë)

... Dhe nuk është pak, nuk është as 10 euro, ashtu siç flitet, është plot 22.5 euro. Pra, tani e tutje, për një biznesmen, turist, ose qytetar që kërkon të vizitojë të afërmit e vet, çdo person duhet të paguajë një taksë të kripur për të lëvizur midis tyre... Një miku im para disa ditësh më tregoi se si mund të shkoja të vizitoja Parisin nga Prishtina për 35 euro... U çudita. Mos u çudit - më tha - dhe nuk do ta bësh me veturë, por me avion. Prishtinë- Paris me avion vajtje 35 euro, vajtje- ardhje 70 euro. U çudita, por edhe u gëzo- va, duke menduar që sa larg është Parisi, kryeqyteti i Europës që unë ende nuk kam mundur ta shoh Parisin dhe sa afër të duket kur paga- sa vajtje-ardhje ishte vetëm 70 euro.

Lajmi i djeshëm në shtyp për krijimin e një taksë të re rrugore, kinsë vetëm 10 euro vajtje-ardhje për në Kosovë, më çuditi pa masë, pasi vinte në kohën e afrimit të pushimeve verore. Mendova se si do ta presin këtë taksë të re qindra e mijëra kosovarë, që kanë bërë planifikim për t'i kaluar pushimet verore në Shqipërinë mëmë... Në fakt, kjo taksë vihet vetëm për kosovarët, dhe quajeni si të doni, në doni quajeni taksë patriotizmi për kosovarët e varfër, në doni quajeni taksë e re serbe për kosovarët që dëshirojnë të vizitojnë atdheun mëmë, quajeni si të doni, në fakt ajo është një taksë e re, e cila u kërkon shqiptarëve që të shtrëngojnë rripat, nëse duan të takojnë njëri- tjetrin. Kjo taksë do të rëndojë mbi kurrizin e shqiptarëve, që kërkojnë të lëvizin lirish në të dyja anët e kufirit. Pa mendoni pak se çfarë

Rruga e Kombit, taksa e patriotizmit për kosovarët



taksë, edhe më e lartë bëhet kjo për kuksianët dhe prizrenasit, që bëjnë tregti me Kosovën dhe kanë vajtje ardhje të shumta. Pa mendoni se çfarë taksë është kjo për një prizrenas, apo pejas, të cilët për një orë përfundojnë në Kukës. Përse ata duhet të paguajnë dhe 10-euroshin dhe 2.5 euro, dhe naftën ose benzinën dhe taksën e qarkullimit. Dhe kjo taksë shtohet në kohën kur flitet për bashkim ekonomik e kulturor të shqiptarëve, për zgjedhjen e një presidenti të vetëm për të dyja shtetet, për heqjen e vizave të kosovarëve me Europën, ndërkohë që kjo taksë e re mund të quhet për kosovarët dhe shqiptarët si një taksë vize, të paguash vizën për çdo hyrje-dalje.

Zotërinj të dashur, shqiptarët e të dyja anëve të kufirit e kanë paguar këtë bashkim me gjakun e tyre shekullor... Tani që erdhi demokracia dhe lëvizja e lirë, u gjendkan të tjera

forma djallëzore për ta penguar lëvizjen e lirë të shqiptarëve... U vihet një taksë e re, të cilën nuk e kanë as shtetet tona fqinje, një taksë që të mos kuptohet, një taksë, kinsë për mirëmbajtjen e Rrugës së Kombit... të asaj rruge që është paguar me gjak nga shqiptarët... Ta marrësh dhe ta interpretosh këtë taksë nga të gjitha anët, madje edhe nga pikëpamja ligjore, ajo nuk qëndron. Është absurde, nuk mund të vendoset një taksë e re mbi një rrugë të papërfunduar. Duhet të dini që janë ende gjashtë ura të parealizuara dhe është një segment i gjatë rruge që fillon në Rrëshen, i cili ka mbetur vetëm me një korsio... Rrugët, miqtë e mi, tatonen mbasi përfundohen. Përfundojeni një herë këtë rrugë, pastaj tatojeni... Një zonjë që foli në emisionin e mëngjesit të "News 24", dukej që ishte socialiste pasi ia hidhte fajin LSI-së, bënte krahasime me taksat që paguhesh në

rrugët e Greqisë. Mirë moj zonjë, por Greqia i ka ngritur këto rrugë duke i dhënë me koncesione dhe koncesioneri sigurisht, do të nxjerrë parat e veta dhe përfitimet e veta, ndërsa Rruga jonë e Kombit nuk është bërë me investime koncesionare, por me parat tona, të taksapaguesve dhe mbi të gjitha është një rrugë e shenjtë për shqiptarët, ndaj dhe quhet krenarisht Rruga e Kombit. Po të bëjmë edhe pak histori, kjo rrugë nuk do të ishte bërë kurrë, po të mos ishte iniciativa e Partisë Demokratike e atyre viteve. U përfol shumë dhe vazhdon të përflitet për vjedhje në shuma të mëdha, ndërkohë që firma amerikane që e fitoi tenderin ia kaloi me nënkontraktor një firmë turke, kështu që paratë e vjedhura kërkojini në bilancet e bëra midis dy firmave të mëdha dhe mos ua kërko- ni qeveritarëve shqiptarë. Është e vërtetë edhe ajo që pushtetarët shqiptarë për çdo punë që bëhet në

Shqipëri nga firmat e huaja marrin bakshishe, por bakshisheet quhen vjedhje, janë të ndara këto lloj dy përfitimesh. Pushtetarët shqiptarë kanë marrë dhe do vazhdojnë të marrin bakshishe, ua them unë, dhe në këtë mes, edhe në firmosjen koncesionare të kësaj taksës të re dikush prej pushtetarëve e ka marrë ose do ta marrë bakshishin... Kjo nuk ka nevojë për koment. Merrni bakshishe zotërinj pushtetarë, se pushtetin për të pasuruar ju vetë në radhë të parë e keni marrë, por kur vjen fjala për bashkimin e shqiptarëve, kur vjen fjala për këtë rrugë të shenjtë të shqiptarëve, e cila u krijua me mundim, bëhuni pak edhe ju shqiptarë, mendoni si shqiptarë dhe thojni 'jo' kësaj taksë të re, e cila merr një kuptim simbolik, simbolizon ndarjen ose bashkimin e shqiptarëve, simbolizon ëndërrën shekullore për bashkim dhe lëvizje të lirë... Unë kam ëndërruar gjithmonë që të realizo- hej linja hekurudhore Tiranë- Prishtinë. Unë e kam prituar atë çast kur shqiptarët do të udhë- tojnë drejt njëri-tjetrit në mënyrë edhe më komode. Sikur të ishte fja- la për të dhënë kontribut për in- vestime në rrugën hekurudhore që do të lidhte Tiranën me Prish- tinën, unë do të isha i pari që do të kontribuoja në këtë drejtim... Mirëpo, me sa dëgjojmë, pushteti i parasë po bën të kundërtën. Rrugën hekurudhore e ka harru- ar, rrugën tjetër Tiranë-Shkup e ka hedhur në kalendra, ndërkohë që ja, si një rrufe në mot të kthjellët vjen dhe taksë më e re, të cilën unë do ta quaja me plot të drejtë taksë e patriotizmit të kosovarëve.

MARRËDHËNIET ME GREQINË "Çështja e paqenë e detit", promovohet botimi i ri i diplomatit Shaban Murati

Diplomati dhe publicisti i njo- hur, Shaban Murati nuk e dinte se negociatat me Gre- qinë për çështjen e detit do të rinis- inin pikërisht në momentin kur ai do të publikonte librin e tij të radhës.

Botimi i ri që analizon mar- rëdhëniet dypalëshe me Greqinë dhe specifikisht "paktin detar" u promovua dje në kulmin e debatit politik për këtë çështje. Libri i dedikohet kryesisht negociatave dhe marrëveshjes së 9 vjetëve më parë, të cilën autori e përkufizon si një gabim diplomatik.

"Gjithë procedura e ndjekur në bisedime, gjithë dinamika e dosjes së detit të lënë shijen ose të jep përfundimin që aty ka pasur një bashkëfajësi apo një intrigë diplo- matike të të dyja palëve", u shpreh ambasador Murati.

"Çështja e paqenë e detit një intrigë diplomatike greke apo shqiptare" dhe negociatat që do rinis- in së shpejti ka ngacmuar reagimin e shumë diplomatëve të tjerë dhe historianëve të pranishëm që dhanë opinionet e tyre nga du- het të nisnin këto bisedime. Prof. Dr. Ksenofon Krisafi dhe ish-anëtar i Gjykatës Kushtetuese, Sokol Sa- dushi e vlerësuan librin e Muratit si një kontribut të vlefshëm në hapësirën diplomatike.



Fjalën hapëse e mbajti botuesi i njohur, Mehdi Gurra e më pas kontribuan personalitete të tjera.

Ambasador Çlirim Çepani tha se: Burimet e mëdha naftëmbajtëse të zbuluara kohëra e fundit në de- tin Jon vunë në lëvizje diplo- macinë greke dhe lobet pro-greke ose kalin e Trojës.

Ndërsa, historiani i njohur Pël- lumb Xhufi u shpreh se: Politika shqiptare ka punuar për ta heshtur apo për ta fshëhur axhendën shqiptare në marrëdhëniet me sh- tetin grek.

Libri titullohet "Çështja e paqenë e detit: një intrigë diplo- matike greke apo shqiptare?". Ai është në shqip dhe në anglisht dhe në brendësi janë publikuar edhe do- kumente të ndryshme nga arkivi i Ministrisë së Jashtme për mar- rëdhëniet Shqipëri-Greqi që nga viti 1967.

SLLOVAKIA NA MUND 4-1

Dy humbje brenda katër ditësh, Shqipëria e Alban Bushit pëson 4 gola në Sllovakia dhe kthehet me kokën ulur në Shqipëri. Kjo është vërtetë shuplakë turpëruese për kuqezinjtë tanë, të cilët jo vetëm që bëjnë lojë skandaloze në mbrojtje, por as ato pak raste që krijojnë për shënim nuk arrijnë që t'i konkretizojnë. Me këtë humbje, ëndrra e Shqipërisë U-21 për të shkuar në European duket se përfundon këtu. Pjesa

e parë e takimit foli për sllovakët, të cilët e gjetën rrugën e rrjetës dy herë. Shqipëria bëri lojë të vakët në minutat e para të ndeshjes, ku në minutën e 19 Harslin gjuajti dhe gjeti rrjetën për të çuar rezultatin 1-0 për vendësit. Ritmi u rrit me kalimin e minutave, por vendësit kontrollojnë lojën dhe krijojnë raste më të mira, duke gjetur edhe golin e dytë në minutën e dytë të shtesës së pjesës së parë. 2-0, Mraz tund rrjetën dhe Alban Bushi mbledh lojtarët ndoshta për t'u

Humbje dhe lojë skandaloze! Alban Bushi, përgjegjës për Shpresat

dhënë leksion në dhomat e zhvishjes. Megjithatë, pjesa e dytë nis e mirë për kuqezinjtë. Lojë e fortë dhe sul-



muese, derisa Rey Manaj gjen rrjetën në minutën e 63. Lushnjari që luan për Granadan në Segunda Division në Spanjë tundi rrjetën dhe shtoi shpresat për të marrë pikë, por kjo grintë nuk zgjati shumë minuta. Siplak në minutën e 71 çon shifrat në 3-1 dhe tri minuta pas tij është sërish Mraz, që gjen rrjetën për herë të dytë në këtë sfidë, 4-1. Pak sekonda më pas kuqezinjtë krijojnë një shans të artë me Hakajn, por që Rodak pret dhe ndal sferën që në atë moment mund të rihapte

shpresat e Shqipërisë. Të njëjtën gjë e përsërit Manaj në minutën e 86 të ndeshjes, por Rodak bën pritje të mrekullueshme. Deri në përfundim nuk ka ndryshim rezultati, Sllovakia na mund për herë të dytë brenda 4 ditësh, duke na shënuar 7 gola në total, ndërsa justifikime për paraqitje të tilla nuk mund të ketë, sikundër bëri Alban Bushi pas sfidës së humbur në "Selman Stërmasi", duke ia faturuar gjithçka ndodhi terrenit të lojës.

Mbrojtësi është i zhgënjyer nga ndeshja ndaj Norvegjisë, por premtori rikthimin



Jeton Selimi

Kombëtarja gjen Ukrainën, Hysaj: Tifozë, mos u shqetësoni

Shqipëria siguron një miqësore të fortë në qershor

E dhe pse Panuçi prefëron të mos japë shumë informacion, "Supersport" ka mundur të mësojë se miqësorja është tanimë e fiksuar është me Ukrainën. Një test kundër skuadrës së Andriy Shevchenkos, që i mbylli eliminatoret e "Rusi 2018" në vendin e 3-të në grupin I ku ndodhej edhe Kosova, një rival i fortë që mban vendin e 35 në renditjen aktuale të FIFA-s. Në takimin e fundit që Shqipëria ka pasur me Ukrainën, në përballjen miqësore të zhvilluar në Bergamo qershorin e 2016-ës para Europlanit, kuqezinjtë humbën 3-1, ndërkohë që në bilancin e përgjithshëm të ndeshjeve direkte në 5 takime të zhvilluara, Shqipëria ka mundur të marrë vetëm një barazim, ndërsa 4 takimet e tjera janë fituar nga ukrainasit. Kundërshtarit tjetër mbetet ende për t'u mësuar, ndërkohë që është i njohur tanimë fakti se Shqipëria do të ketë një grumbullim 8-ditor në Zvicër për t'u përgatitur si duhet në



2 miqësoret e fundit para ndeshjeve zyrtare të Nations League, që nisin në shtator. Gjithsesi, pavarësisht kushteve komode që

ofron shteti helvet, për Panuçin nuk pritet të jetë një grumbullim i lehtë, pasi lojtarët do të jenë në fund të sezoneve me klubet respek-

tive e rrjedhimisht në pritje të pushimeve, ndërkohë që disa prej tyre rrezikojnë të mos shkojnë me moralin në maksimum në miqësoret e

majit, pasi rrezikojnë seriozisht të bien nga kategoria me klubet e tyre, bëhet fjalë këtu për lojtarë të rëndësishëm si Mavraj me Hamburgun, që ndodhet në vendin e fundit të Bundesligës dhe rrezikon të bjerë për herë të parë nga kategoria, po ashtu në vendin e fundit në Itali renditen edhe Memushaj apo Gjimshiti të Bevenuto, ndërkohë që rrezikon edhe Krotone ku luan Ajeti, ndërsa në kampionatin zviceran rrezikon të provojë rënien Sion ku luan Lenjani dhe që mban vendin e fundit në Superligën helvete.

HYSAJ

Shqipëria humbi përballë Norvegjisë në një ndeshje miqësore, e cila u luajt në

"Elbasan Arena" dhe që u mbyll me shifrat 0-1. Futbolisti më i shtrenjtë i Kombëtares sonë, Elseid Hysaj u shpreh për "VipSport" se ajo ishte vetëm një ndeshje ku mungoi forca fizike dhe iu bënë thirrje tifozëve për t'i mbështetur pasi sipas tij, nuk ka asgjë për t'u shqetësuar. Hysaj doli i dëmtuar nga ndeshja, ndërkohë që tregon edhe se ka pasur shumë interesime për gjendjen e tij shëndetësore. "Ishim pak poshtë fizikisht dhe kjo ishte gjëja që nuk na favorizoi, por besoj që ndonjëherë ndodh të jemi poshtë, por duhet të marrim veten. Përgatitja nuk ishte e keqe, por kur filluam të kërkojmë më shumë, gabuam. Besoj se kemi bërë mirë në stërvitje dhe disa lojtarë të rinj e kanë marrë sensin e Kombëtares së madhe. Nuk kishim fuqi të shkonim nga porta në portë, por tifozët nuk duhet të shqetësohen, pasi i kemi pasur pranë gjithmonë si në fitore, si në humbje. Kam marrë me qindra mesazhe dhe nuk më ka pushuar telefoni. Të gjithë më kanë pyetur në lidhje me dëmtimin", u shpreh Hysaj.

ZIKALTRIT

Interi bëhet gati për një ndryshim të papritur, që mund të ndikojë ecurinë e mëtejshme të zikaltrëve dhe projektin e tyre. Sipas mediave italiane, Valter Sabatini ka dorëzuar dorëheqjen që dy javë më parë, në pritje të vendimit përfundimtar të grupit "Suning", që kontrollojnë zikaltrit. Koordinatori i departamentit teknik në klubin italian nuk e ka pëlqyer mënyrën se si çdo tentativë e tij për të përforcuar skuadrën në janar është refuzuar nga drejtuesit e klubit. Ata nuk deshin që të investonin shifra të rëndësishme për të afruar emra si Pastore, Ramires

Dështimi i radhës, Interi bën gati largimin e Sabatinit



e Tekseira, ndërsa kishte vështirësi të mëdha edhe në menaxhimin e Jiangsu Suning në kampionatin kinez. Sabatini ka kërkuar autonomi të plotë në vendimet e tij, por nuk e ka

gjetur, ndaj është detyruar të paraqesë dorëheqjen, në pritje të përgjigjes nga klubi që do ta pranojë atë, ose do t'i mundësojë vendimarrjen siç dëshironte.

ATENTATI NDAJ ISH-SPIUNIT

Para disa javësh, në Sal isburi të Anglisë ndodhi një sulm me lëndë kimike, ku në shënjestër ishin ish-spiuni rus Sergei Skripal dhe vajza e tij, ndërkohë që nga ky sulm rrezikuan të vdisnin 150 banorë të tjerë, pasi lënda e përdorur ishte shumë e rrezikshme. Pas hetimeve të para, u arrit në përfundimin se sulmi është urdhëruar nga qeveria ruse, ku Vladimir Putin ka qenë ai që ka kërkuar të vritet ish-spiuni. Ky akt është dënuar nga kryeministria angleze, Tereza Mej, e cila është shprehur se asnjë delegat nga Anglia nuk do të marrë pjesë në ceremoninë hapëse të Botëror-


Kaos me Botërorin! 6 vende mund ta bojkotojnë



it, i cili do të mbahet në Rusi. Ky vendim është përhëndëtur edhe nga disa zyrtarë të kombëtareve të tjera, të cilët po mendojnë që të refuzojnë ftesat në shenjë solidarizimi për Salisburin. Zyrtarë nga Polonia, Islanda, Danimarka,

Suedia, Australia dhe Japonia njoftojnë se shtetet e tyre do të refuzojnë ftesën për të marrë pjesë në ceremoninë hapëse, ku i pari që e ka marrë këtë vendim ka qenë presidenti i Polonisë, Andrzej Duda.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Riza aktor.
- Një fjalë si hiç.
- Një mund të jetë diplomatik.
- Premton të bëhet as.
- Janë felinë... të zinj.
- Ami i Maupassant.
- Heroi i Emilio Salgarit.
- Oe anarkist i famshëm rus
- Një mungesë gjaku.
- Susanna shkrimtare
- Të parat në cilësi.
- Mbyllin një shtëpi.
- Mbeten në fund.
- Qendër në kaos.
- Ka brrirë piktoreskë një i tillë
- Inicialet e Camus.
- Motra... e Kolë Idromenos
- Një konfuzion total.
- Rastet pa set.

- Rastisin në krye.
- Fillojnë detyrën.
- Bektashi këngëtare.
- Andrea aktore.
- Sampras i tenisit.
- Shkroi Korbi (indic).
- Triolet e Trëndafilë me kredi.
- Kilmer aktor.
- Në krye të robotëve.
- Unë dhe ti.
- Një mund të jetë fetar.
- Stephane poet francez

VERTIKAL

- Fillojnë praktikën.
- Britna e Arkimedit.
- Ekstremit në trap.
- Në fund të fundit.
- Janë fjetoret e ushtarëve
- Parker regjisor.
- Vivaldi kompozitor.
- Një shkop për karambol.
- Janë firmat rentiere.
- Një i fundit mbi të gjithë
- Kufizojnë tatimet
- Janë nomadë.
- Panik pa kufij.
- Fryn detin.
- Sidney regjisor i Serpico.
- Jep alarmin.
- Fillojnë nazet.
- Janë llogari.
- Alan regjisor.
- Roman regjisor.
- Eshtë X ajo e sulmit.
- Kapen të parat.
- Një provë... intelligence.
- Një markë lap top.
- Fillojnë matjet.
- Ruga e Ferenc Molnar.
- Qerre pa qe.
- Fillojnë lirinë.
- Fillojnë vallen.
- Në mes të dhomës.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Një doktor... i Fritz Lang
- U paraprinë hoteleve.
- Kush nuk ka... nuk ha
- Eshtë djall
- Një mund të ketë i rrallë.
- Ishin perëndi të Samotrakias.
- Institucione Botuese Autonome.
- Eshtë infeksion në bark
- Fundi i një samurai.
- Një markë kafeje.
- Mund të jetë emërore.
- Ishte muzikanti që nuk përsëriste.
- Në krye të avokatëve.
- Qerre pa qe.
- Një pjesë e adoloshentëve.
- Një banor imagjinar i planetit të kuq.

VERTIKAL


- James, armiku i Sherlock Holmes.
- Eshtë edhe ajo saudite.
- Imami aktore
- I kanë çift turket.
- Inicialet e Seagal aktor.
- Eshtë dëshmore... çudibërëse.
- Në fund të lutjes.
- Eshtë sporti me stil të lirë.
- Mbeten në fund.
- Eshtë rasti i veçantë, karakteristik.
- Conan ai i Schwarzenegger.
- Gjysmë ditari.
- Mario, që qe bomber argjentinas.
- Mund të prishej nga një... kleçkë.
- Në hyrje të pistës.
- Një numër... femrash.
- Eshtë qyteti i Besës
- Qyteti që quhej edhe Sebaste.
- Njëllot për latinët.
- Mund të bëjnë stil të lirë.
- Damon aktor.
- Eshtë pije e jona.
- Në krye të noterëve.
- Film i Robert Altman.
- Skuadra merengue.
- Një pjesë e hasmërisë.
- Rrallë është përgjysmë.
- Nisur pa kufij.
- Fillojnë mobilizimin.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

	5	6		9	8		1	
4	3	9	2					
7				3			5	2
8				4	7			
1		4					6	2
				6	1			8
	1	3		7				6
							5	9
					9	8	3	
2		9	6			4	7	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	1	3	4	8	6	5	7	9
7	9	8	3	1	5	4	2	6
4	5	6	9	7	2	8	3	1
3	6	4	1	5	8	2	9	7
9	7	5	6	2	3	1	4	8
1	8	2	7	9	4	3	6	5
5	2	7	8	4	9	6	1	3
6	4	9	5	3	1	7	8	2
8	3	1	2	6	7	9	5	4


Argëtim filozofik

- Mediocriteti nuk rreth asgjë më të lartë se veten e vet. (A. Konan Dojl)
- Asnjë nuk është e vogël për një mendje të madhe. (Sherlok Holms)
- Për të njohur vetveten, duhet ditur gjithçka për të tjerët. (Oskar Uajlld)
- Ka diferencë të madhe midis pëlqimit dhe dashurisë... Nëse të pëlqen një lule e këput menjëherë, ndërsa kur e do e 'ujt' dhe përkujdesesh për të gjithmonë..

Populli

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



Thënie të mençura

- Kur jemi të rinj mësojmë, kur jemi të vjetër kuptojmë.
- Ne jemi mësuar të kemi respekt për ankthet tona, por duhet të mësojmë të kemi respekt për veten dhe nevojat tona. **Andre Lardé**
- Nëntë të dhjetat e zgjuarsisë qëndron në të qënit i mençur në kohën e duhur. (Teodor Ruzvelt)
- I mençuri ka një prijte të fortë për të qenë i heshtur, dhe aftësinë për të ruajtur një inventar të tërë sekretesh. Zotësia dhe karakteri i tyre janë për t'u respektuar. (Baltazar Gracian)

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

